

# T'i thyejmë tabutë rreth varfërisë



**Ide kreative për zbutjen e  
pasojava nga varfëria**

**Aktivitete mësimore**

**T'i  
thyejmë  
tabutë rreth  
varfërisë**

**Ide kreative për zbutjen e  
pasojeve nga varfëria**

**Aktivitete mësimore**

## IMPRESIUM

**Botues:** Rrjeti i qendrave për politikë arsimore (NEPC) – Zagreb, 2019

**Për botuesin:** Lana Jurko

### Autorë:

Branka Xhajkovska (Fondacioni për initiative arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”, Shkup, Maqedonia e Veriut) – Kreu 2.2

Majda Joshevska (Fondacioni për initiative arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”, Shkup, Maqedonia e Veriut) – Kreu 2.2

Suzana Kiranxhiska (Fondacioni për initiative arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”, Shkup, Maqedonia e Veriut) – Kreu 2.2

Vanja Kozhiq Komar (Forumi për liri në arsim, Zagreb, Kroaci) – Kreu 2, Hyrja, Kreu 2.1

Jelena Vranjesheviq (Universiteti i Beogradit, Fakulteti i Filozofisë, Beograd, Serbi) – Kreu 1

*Shembujt për aktivitete në shkollë janë përgatitur nga:* Shkolla Fillore “Dane Krapçev”, Shkup, Maqedoni; Shkolla Fillore “Tishina”, Tishina, Slloveni; Shkolla Fillore “Vinko Zhganec”, Zagreb, Kroaci

### Përktheu dhe përshtati:

Lulzim Ademi

**Projekti:** T'i thyejmë tabutë rreth varfërisë: roli dhe përgjegjësia e arsimit ERASMUS+ - Aksioni kyç 2 Partneritete strategjike

### Partner të projektit:

Rrjeti i qendrave për politika arsimore (NEPC)

Instituti për hulumtime arsimore, Lubjanë, Slloveni (ERI)

Forumi për liri në arsim, Zagreb, Kroaci (FFE)

Fondacioni për iniciativa arsimore dhe kulturore “Hap pas hapi”, Shkup, Maqedonia e Veriut  
PRAKSIS, Talin, Estoni (PRAKSIS)

Shkolla Fillore “Dane Krapçev”, Shkup, Maqedonia e Veriut

Shkolla Fillore “Tishina”, Tishina, Slloveni

Shkolla Fillore “Vinko Zhganec”, Zagreb, Kroaci

### Dizajn grafik:

Lidija Bozic Jovanovska



Co-funded by the  
Erasmus+ Programme  
of the European Union

Ku publikim është përgatitur me ndihmën e Bashkësisë Evropiane.

Për përmbajtjen e këtij publikimi përgjegjësi kanë vetëm autorët dhe e njëjta aspak nuk i reflekton qëndrimet e Bashkësisë Evropiane.

## PËRMBAJTJA

<b>1. VARFËRIA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËS: IMPLIKIME ARSIMOREM</b> .....	<b>5</b>
<b>2. BALLAFAQIMI ME PABARAZINË SOCIO – EKONOMIKE NË SHKOLLË</b> .....	<b>13</b>
<b>2.1. Klasa dhe aktivitete jashtë mësimore</b> .....	<b>16</b>
<b>Shkolla Fillore “Dane Krapçev”</b> .....	<b>16</b>
<b>Shkolla fillore “Tishina”</b> .....	<b>18</b>
<b>Shkolla fillore Dr. Vinko Zhganec</b> .....	<b>21</b>
<b>Shkolla fillore “Motovun”</b> .....	<b>24</b>
<b>Shkolla fillore “Trpinja”</b> .....	<b>26</b>
<b>Shkollë e mesme Pullëa</b> .....	<b>28</b>
<b>Shkolla e mesme “Vitorio Emanuele II”</b> .....	<b>29</b>
<b>2.2 PUNËTORI PËR NXËNËS, MËSIMDHËNËS DHE PRINDËR</b> .....	<b>31</b>
<b>1. Aktivitet: Ky jam unë</b> .....	<b>33</b>
<b>2. Aktiviteti: Kolazhi im</b> .....	<b>35</b>
<b>3. Aktiviteti: Elementi im</b> .....	<b>37</b>
<b>4. Aktiviteti: Ndjeje “rrjedhën”</b> .....	<b>41</b>
<b>5. Aktiviteti: Nga inspirimi deri tek aksioni</b> .....	<b>42</b>
<b>6. Aktiviteti: Kutia e lumturisë</b> .....	<b>45</b>
<b>7. Aktiviteti: Unë në pasqyrë</b> .....	<b>46</b>
<b>8. Aktiviteti: Recetë për shkollë të lumtur</b> .....	<b>47</b>
<b>9. Aktiviteti: Nga nevoja deri te ide të projekteve</b> .....	<b>50</b>
<b>10. Aktiviteti: Përtej vijës</b> .....	<b>52</b>
<b>11. Aktiviteti: Pasioni për modën</b> .....	<b>56</b>
<b>12. Aktiviteti: Krenohemi me nxënësit tanë</b> .....	<b>57</b>
<b>13. Aktiviteti: Të ecësh në këpucë të huaja</b> .....	<b>58</b>
<b>14. Aktiviteti: Dekorimi i klasës</b> .....	<b>60</b>
<b>15. Aktiviteti: Shkëmbejmë dhe kujdesemi</b> .....	<b>61</b>
<b>16. Aktiviteti: Aftësi ripërtëritëse psikologjike</b> .....	<b>62</b>
<b>2.3 AKTIVITETE VULLNETARE NË SHKOLLË - ÇFARË JU BIE NDËRMEND</b> .....	<b>67</b>
<b>Literatura dhe referencat:</b> .....	<b>69</b>



## 1. VARFËRIA DHE ZHVILLIMI I FËMIJËS: IMPLIKIME ARSIMORE

Studimet kërkimore për ndikimin e varfërisë në zhvillimin dhe mirëqenien e fëmijëve zakonisht realizohen nëpërmjet krahasimit të zhvillimit të fëmijëve të cilët rriten në varfëri me zhvillimin që kanë shokët e tyre të klasës të cilët rrjedhin nga familje të klasës së mesme ose nga familje më të pasura. Metoda tjetër për ndikimin e varfërisë në zhvillimin e fëmijës e hulumton lëvizshmërinë ekonomike, gjegjësisht pasojat e rritjes së shpejtë të të ardhurave personale në zhvillimin e fëmijëve dhe mundësisë për zbutje të pasojave të varfërisë mi zhvillimin e hershëm të fëmijëve (Daring, 2008). Për dallim nga hulumtimet fillestare për varfërinë të cilët e trajtonin varfërinë si fenomen statik, hulumtimet e fundit të varfërisë e pranojnë natyrën dinamike të varfërisë dhe e marrin parasysh **kohën** dhe **kohëzgjatjen** e varfërisë kur i shqyrtojnë efektet në zhvillimin e fëmijës (Meklojd, 1998). Në raport me kohëzgjatjen e varfërisë, u tregua se varfëria e zgjatur ka efekt më të dëmshëm në zhvillimin e hershëm të fëmijës sesa varfëria afatshkurtër (Dankan dhe të tjerë 1994). Rezultatet e studimit nuk janë aq konsekuente për sa i përket çështjes së kohës, gjegjësisht periudhës së zhvillimit kur fëmijët të cilët jetojnë në varfëri janë më të cenueshëm; disa studime tregojnë se pasojat e dëmshme të varfërisë janë më të dukshme në disa vitet e para të jetës, derisa të tjerë e theksojnë periudhën e mesme të fëmijërisë si periudhë veçanërisht të ndjeshme (Daring, 2008).

Rezultatet nga studimet e ndryshme tregojnë një korrelacion të fortë mes varfërisë dhe të gjithë aspektet e zhvillimit të fëmijës: zhvillimi njohës (kognitiv) dhe socio – emocional, arritjeve në shkollë, aftësive ripërtëritëse dhe mekanizmave të reagimit etj. Dallimet mes fëmijëve të varfër dhe shokët e tyre të klasës që janë më të pasur veçanërisht janë të dukshëm kur janë në pyetje zhvillimi njohës (kognitiv) dhe zhvillimi i gjuhës. Disa nga studimet tregojnë se fëmijët të cilët jetojnë në varfëri deri në moshën katër vjeçare, arrijnë sukses më të dobët në teste nga fëmijët të cilët nuk kanë jetuar në varfëri në atë moshë (Daring, 2008). Hulumtimet gjithashtu tregojnë se pasojat e varfërisë janë më relevante për zhvillimin njohës (kognitiv) sesa faktorë të tjerë siç janë arsimit ose aftësitë njohëse (kognitive) të prindërve (Tejlor, Daring&Mekkartni, 2004). Fëmijët e varfër dhe fëmijët nga familjet me status më të ulët socio – ekonomik (SSE) kanë arritje më të ulëta nga shokët e tyre të klasës të cilët i takojnë klasës së mesme në shumë tregues të suksesit akademik siç janë pikët në teste, përsëritje, nota, përqindja e mbarimit të shkollimit të mesëm, përqindja e lëshimit të shkollimit të mesëm dhe vitet e arsimit të mbaruar (Meklojd, 1998). Fëmijët të cilët jetojnë në varfëri kanë dymbëdhjetë herë gjasa më të vogla të mbarojnë shkollën e mesme sesa fëmijët e tjerë (Dankan, Jang, Broks-Gan&Smith, 1998).

Studimet të cilat i përpunojnë efektet e varfërisë në zhvillimin socio – emocional tregojnë se fëmijët që rriten në varfëri kanë gjasa më të mëdha për probleme socio – emocionale në më shumë fusha: (1) nxjerrja jashtë të problemeve ndër personale si agresioni, sjellja shkatërruese dhe hiper aktivitet; dhe (2) mbyllja brenda të problemeve ndër personale si ankthi, depresioni dhe frikë (Dankan&Broks-Gan, 1997, Meklojd, 1998; Broks-Gan&Dankan, 1997; Tejlor, Daring&Mekkartni, 2004). Ata njëkohësisht kanë nivele më të ulëta të kompetencave sociale në raportet e tyre me shokët e tjerë të klasës dhe me të rriturit (Daring, 2008). Mbyllja brenda e problemeve më së shpeshti është rezultat i varfërisë së vazhduar që shpjegohet me pasojat e gjendjes së pavolitshme kronike në sistemet neurobiologjike të stresit të fëmijët dhe faktit që të rinjtë të cilët jetojnë në varfëri me probabilitet më të madh tregojnë markerë neuroendokrin të stresit kronik sesa të rinjtë të cilët nuk janë të varfër (Daring, 2008).

Por duhet të vërehet se raporti mes mbylljes brenda dhe varfërisë nuk është linear: fëmijë nga familje më të pasura gjithashtu janë të cenueshëm dhe u nënshtrohen problemeve të ndryshme socio – emocionale (ndoshta sepse prindërit nuk kanë kohë dhe nuk futen në mënyrë emotive në plotësimin e nevojave të fëmijëve të tyre). Nga ana tjetër, nxjerrja jashtë e problemeve më së shpeshti është pasojë e varfërisë afatshkurtër, e cila në jetën e fëmijëve fut ndryshime, mospërputhje dhe pa parashikueshmëri, kurse reagimi i tyre i zakonshëm janë probleme në sjellje si për shembull agresion ose hiper aktivitet (Daring, 2008).

### VARFËRIA DHE FAMILJA: Lidhja mes mirëqenies ekonomike të familjes dhe mirëqenies psikologjike të fëmijëve

Teoricienët dhe hulumtuesit të cilët i përpunojnë pasojat e varfërisë pajtohen se karakteristikat më të shpeshta të rrethit fizik dhe përvojës psiko – sociale të fëmijëve të cilët jetojnë në varfëri janë:

- (1) Mungesë e resurseve të cilat e stimulojnë dhe mbështesin zhvillimin – që nënkupton edhe mungesë të resurseve materiale (libra, lodra, materiale didaktike etj.) dhe resurse psiko – sociale, që mund të jetë kohë e kaluar me prind ose në aktivitete të përbashkëta familjare (Foster, 2002).
- (2) Numri i madh i stresuesve diskret dhe kronik të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë ndikojnë mbi mirëqenien e fëmijës – psikologët e zhvillimit e theksojnë lidhjen mes varfërisë dhe stresit prindëror i cili mund t'i pengojë veprimet dhe sjelljet prindërore pozitive, siç janë ngrrohtësia dhe plotësimi i nevojave dhe dëshirave të fëmijës dhe ta forcojë mosinteresimin, kujdesin e ashpër dhe të paqëndrueshëm. (Elder&Kaspi, 1998). Studimet tregojnë se prindërit të cilët jetojnë në varfëri kanë prirje që më shumë t'i dënojnë fëmijët e tyre dhe më pak t'i plotësojnë nevojat e tyre në krahasim me prindërit e tjerë (Bredli e tjerë, 2001). Përveç kësaj, fëmijët të cilët jetojnë në varfëri janë të ekspozuar rrethimit kaotik në dhe jashtë shtëpisë që ka pasojat negative në aftësitë ripërtëritëse dhe mekanizmave konstruktiv për ballafaqimin me stresin (Daring, 2008). Fëmijët e varfër zakonisht regjistrohen në shkollë më të dobëta. Ata më së shpeshti janë dhunës së bashkëmohatarëve sesa shokët e tjerë të klasës, nuk marrin mbështetje dhe nuk kanë ndërveprime pozitive me shokët e klasës, gjithashtu kanë më pak ndërveprim edhe me mësimitdhënësit (Pianta e tjerë, 2002).

### VARFËRIA DHE ARSIMI: Ndikimi në zhvillimin e fëmijës dhe arritjet arsimore

Arsimi luan rol kyç në thyerjen e rrethit të varfërisë. Rëndësia e arsimit theksohet edhe në dokumentet për të drejtat e njeriut dhe në studime të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik dhe social. Sipas Deklaratës universale për të drejtat e njeriut (1984), arsimi duhet të jetë pa pagesë dhe i detyrueshëm (neni 26). Konventa për të drejtat e fëmijëve thekson se arsimi duhet të jetë i mundshëm dhe i arritshëm për të gjithë fëmijët pa diskriminim (neni 28) dhe se duhet të jetë me kualitet të lartë (neni 29). Studimet për zhvillimin ekonomik vërtetojnë se arsimi është përcaktues kryesor i të ardhurave të njerëzve – çdo vit i kaluar në shkollë rezulton me të ardhura më të larta për 10% (Burnet, 2008). Studimet për zhvillimin social vërtetojnë se arsimi ndikon pozitivisht në të gjitha aspektet e zhvillimit dhe mirëqenien e fëmijës. Që arsimi të mund t'i plotësojë qëllimet e tij dhe të rrisht t'i zhvillojë potencialet e çdo fëmije, duhet të jetë i kualitetit të lartë. Megjithatë, në një numër të madh të vendeve nxënësit e marginalizuar:

ballafaqohen me mësimitdhënie dhe të nxënë të kualitetit të ulët;

mësojnë në klasë me numër të madh të nxënësve;

nuk kanë materiale për të mësuar;

nuk marrin kohë të mjaftueshme për mësim;

ballafaqohen me paragjykimet gjinore;

kanë mësimitdhënës që nuk kanë përgatitje të duhur.

Edhe pse kualiteti i arsimit varet nga shumë aspekte të politikave arsimore, megjithatë mësimitdhënësit janë ata që në shkollë më të madhe i përcaktojnë rezultatet përfundimtare të procesit arsimor. U tregua se ata kanë ndikimin kryesor në të nxënë sepse qëndrimet dhe praktikat mësimore të tyre ndikojnë në masë të madhe në arritjet e nxënësve. Studimet tregojnë se mësimitdhënësit kanë imazh më pak pozitive për nxënësit e varfër (të papjekur, kanë shkathtësi të dobëta për vetë rregullim, janë të varur) që nga mosha parashkollore. Njëkohësisht presin më pak nga fëmijët e varfër në bazë të disa faktorëve jo-njohëse (jo kognitive) (mënyra e të folurit dhe veshja). Mësimitdhënësit me qëndrime të tilla më pak kushtojnë vëmendje pozitive për fëmijët e varfër, më rrallë u sigurojnë mundësi për të nxënë, nuk e lavdërojnë dhe nuk e nxisin punën e tyre të mirë (Meklojd, 1998).

Ekzistojnë më shumë faktorë të cilët mund të ndikojnë në mësimitdhënien dhe në të nxënë:

1. **Teoria e deficitit** – Teoria e deficitit ishte mënyrë dominuese e sqarimit pse nxënësit e grupeve të cenueshme tregojnë sukses të ulët në shkollë. Përfshin qëndrime se disa grupe/nxënës kanë më shumë prirje për arritje akademike sesa grupi/nxënësit tjerë. Fëmijët e grupeve të marginalizuara zakonisht nuk përshtaten në imazhin që mësimitdhënësi e krijon për nxënësin perfekt dhe mësimitdhënësi e tillë kanë prirje t'i shohin nxënësit e tillë nëpër prizmin e dobësive të tyre në vend të anëve të forta të tyre si dhe kanë pritje më të ulëta për sa u përket aftësive të tyre të arrijnë sukses të mirë (Gorski, 2008). Rreziku nga teoria e deficitit shihet në faktin e mirënjohur për efektet nga pritjet e mësimitdhënësit për arritjet e nxënësve – efekt i njohur si *profecia e cila përmbushet vetëm për vete ose efekti Pigmalion* (Rosental&Jakobson, 1968). Procesi i krijimit të profecisë e cila përmbushet vetëm për vete zhvillohet në këtë mënyrë: a) individ apo tërë grupi *etiketohet* (për shembull, mësimitdhënësi i etiketon nxënësit e cenueshëm si më të paaftë dhe më të pamotivuar në krahasim me nxënësit tjerë), b) mësimitdhënësi fillon të sillet në përputhje me etiketën e vënë. Sjellja e tillë mund të jetë shumë *eksplicite* në raport me etiketën (për shembull, mësimitdhënësi më pak u kushton vëmendje nxënësve nga grupi i cenueshëm, mban mësim të kualitetit më të dobët dhe u jep më pak sqarime sesa nxënësve tjerë, më rrallë u drejtohet dhe shpesh i kritikon etj.), ose *implicite* (për shembull, mësimitdhënësi përpiket “t’ju ndihmojë” ashtu që u jep detyra më të lehta sesa nevojiten për njohuritë dhe shkathtësitë e tyre momentale, dhe c) individ/grupi i etiketuar fillon të sillet në përputhje me etiketën (nxënësit të cilët etiketohen si më të paaftë dhe/ose më të pamotivuar arrijnë sukses më të dobët sesa nxënësit tjerë, e humbin motivimin për të mësuar, largohen etj.), në këtë mënyrë e arsyetojnë etiketën e dhënë.

2. **Varfëria kulturore** – Miti për “varfërinë kulturore” e përpunon idenë se të varfëritë ndajnë pak a shumë qëndrime, vlera dhe sjellje njëfarëshe dhe të parashikueshme që janë përgjegjëse për statusin e tyre të pavolitshëm (ato janë përtac, nuk e respektojnë arsimin, nuk janë të motivuar të mësojnë, etj.). Miti për “varfërinë kulturore” e tërheq vëmendjen nga kultura e rrezikshme e cila me të vërtetë ekziston – kultura e klasave, dhe nga ajo që njerëzit që jetojnë në varfëri *me të vërtetë e kanë të përbashkët*: qasje e pabarabartë deri te të drejtat njerëzore themelore (Gorski, 2008). Mekanizmi i lidhur me mitin për “varfërinë kulturore” i cili shërben që t’i arsyetojë paragjykimet ndaj të varfërve dhe ta mbajë sistemin e shtypjes (opresionit) i cili është i njohur si “akuzo viktimën” (Rajan, 1976). Mekanizmi “akuzo viktimën” i vendos rrënjët e problemeve sociale në karakteristikat e grupeve që vuajnë nga problemet e tilla, në vend që t’i vendosin në sistemin i cili në mënyra të ndryshme i shtyp dhe i cili krijon mundësi të pabarabarta për grupet e ndryshme. Kur e përdorim këtë mekanizëm, përqipemi t’i zgjedhim problemet sociale pa i ndryshuar kushtet të cilat në mënyrë reale i kanë krijuar.

Mekanizmi “akuzo viktimën” zhvillohet nëpër katër hapat vijuese:

- a) Përkufizohet problemi dhe popullatën të cilën ai e godet (për shembull, *Fëmijët rom kanë arritje të dobëta në shkollë dhe sipas të gjitha gjasave do të largohen*),
- b) Krahasohen sistemet e vlerave, kultura dhe sjellja tipike e popullatës me problem dhe të asaj pa problem, zakonisht nëpërmjet stereotipave (për shembull, *Romët e duan lirinë e tyre, nuk janë mësuar të punojnë, nuk e respektojnë arsimin, ato janë të privuar nga shoqëria...*),
- c) Shkaku i problemit vendoset në dallimet mes popullatës me probleme dhe asaj pa probleme (*Fëmijët rom kanë probleme sepse prindërit e tyre nuk e respektojnë arsimin*) gjatë kësaj e injorojnë faktin që këta prindër edhe vetë janë analfabet, nuk e shohin qëllimin e arsimit të fëmijëve që nuk kanë mundësi punësimi, nuk kanë të holla për veshje dhe materiale shkollore si dhe arsye të tjera),
- ç) Realizohen aktivitete që kanë për qëllim ta ndryshojnë popullatën “problematike” (për shembull, t’i ndryshojnë raportet familjare, e përjashtojnë gjuhën dhe kulturën e tyre, t’i ndryshojnë traditat e tyre, ose t’i trajtojnë të përvetësojnë sjellje tipike që kanë grupet pa probleme – t’i regjistrojnë fëmijët rom në shkolla speciale që *“t’ju lehtësojnë*”, të bëjnë shtypje prindërit t’i regjistrojnë fëmijët në shkollë duke mos e marr parasysh faktin se fëmijët nuk e njohin gjuhën ose nuk posedojnë shkathtësi të nevojshme për ndjekje të suksesshme të shkollës etj.). Mekanizmi “akuzo viktimën” në thelb shërben që të përforcohen paragjykimet dhe të racionalizohet diskriminimi, gjegjësisht trajtimi i pabarabartë i grupeve të cenueshme. Ky mekanizëm shpesh është kyç në intervenimet e shumta që u dedikoheshin grupeve të cenueshme, duke përfshirë aktivitete të cilat kanë për qëllim ndryshimin e karakteristikave të grupeve që janë në rrezik, e jo ndryshim i rrethanave që janë shkak për cenimin dhe trajtimin e pabarabartë të këtyre grupeve. Ngushtë është e lidhur me *individualizmin garues (kompetitiv)*, qëndrim i cili bazohet në bindjen se secili është përgjegjës për suksesin ose mosp suksesin e vet. Kjo bindje i e injoron rolin e racës, gjinisë, klasës shoqërore ose aspektet tjera të identitetit social të individit. Njëkohësisht e lë anash faktin se secili lind me të njëjtën pikë të fillimit dhe se disa individ janë të privilegjuar që në fillim, e me këtë kanë edhe gjasa më të mëdha të kenë sukses sesa që kanë ata pa privilegje.

## Intervenime për përmirësimin e zhvillimit dhe arritjeve arsimore të fëmijëve

Programet dhe politikat të cilat do të mund t’i zbusin pasojat negative nga varfëria në zhvillimin e fëmijëve varen nga kuptimi jonë i natyrës dhe shkaqeve kryesore të varfërisë (së bashku me strategjitë për daljen nga rrethi i varfërisë). Nëse varfëria përkufizohet nga aspekti ekonomik në bazë të matjes së të ardhurave, programet dhe politikat do të përqendrohen në rritjen e të ardhurave nëpërmjet mundësive të punësimit ose programeve të ndihmës sociale. Nga ana tjetër, nëse shqyrtohet si një situatë e pafavorshme më e gjerë sociale, gjegjësisht mungesa jo vetëm e të mirave materiale, por edhe i aftësive siç janë përkatësia sociale, identitetin kulturor, respekt dhe dinjitet, informata dhe arsim, atëherë programet dhe politikat do të përqendrohen në kontekstin e tërësishëm social që e privon barazinë e të drejtave dhe mundësive dhe që nxit shtypjen (opresionin), pabarazinë dhe padrejtësinë (Engël&Blak, 2008).

Disa hulumtues bartës të politikave shkaqet e varfërisë ia atribuojnë individëve, kapaciteteve të tyre, aftësive, kompetencave, sistemeve të vlerave, motivimin, shkallën e aspiratave arsimore etj. Kështu, intervenimet që ata i zgjedhin për t’u ballafaquar me varfërinë përqendrohen në ndryshimin e mentalitetit të individit, rritjen e motivimit dhe aspiratat të tyre dhe përmirësimin e kapaciteteve të tyre nëpërmjet programeve për arsim dhe mbështetje. Qëllimi kryesor i këtyre programeve është të përmirësohen kapacitetet e individëve ose grupeve të varfra që të mund të ndërmarrin aksion të menduar dhe t’i përdorin mundësitë e tyre (Narajan&Petesh, 2007). Problemi me këtë qasje është në atë që mund t’i forcojë stereotipat/paragjykimet ndaj të varfërve (duke i akuzuar ato për varfëri dhe marginalizim) dhe të mbështet mekanizmat e shtypjes (opresionit) që i mbajnë sistemet e pabarazisë (duke u përpjekur t’i ndryshojë individët në vend që të ndryshojë sistemin e padrejtë).

Qasja tjetër që e përdorin disa hulumtues dhe bartës të politikave e përfshin kontekstin e tërësishëm social dhe faktorët e përjashtimit social të cilat i pengojnë grupet ose kategoritë e personave të dalin nga rrethi i varfërisë. Programet të cilët orientohen drejt kontekstit social përqipen të zhvillojnë dhe të mbajnë mekanizma të cilat sigurojnë barazi dhe të drejtë sociale. Ajo nënkupton ndryshime në strukturën e mundësive, që kultivohen në klimën dominuese institucionale dhe struktura sociale në kuadër të së cilës individët e cenueshëm duhet të veprojnë që t’i kënaqin nevojat dhe interesat e veta (Narajan&Petesh, 2007). Siç përfundohet në raportin analitik të Estonisë i cili bazohet në politikat estoneze dhe vizitës studimore në Estoni të realizuar në kuadër të Projektit BRAVEdu, një kusht gjithëpërfshirës për zvogëlimin e jazit në arritjet mes individëve me status të ndryshëm socio – ekonomik dhe futjen e masave universale, qoftë në raport të politikave të drejtpërdrejta arsimore, politikave sociale dhe shëndetësore që kanë për qëllim ta mbështesin mirëqenien e nxënësve: “Shumica e masave për përkujdesje sociale janë universale dhe kanë për qëllim të sigurojnë mundësi të barabarta për arsim për të gjithë fëmijët, pa marr parasysh prejardhjen dhe karakteristikat e tyre, siç është dreka pa pagesë dhe libra shkollore për të gjithë” (Mlekuzh e tjerë, 2018).

Strategjitë për zvogëlimin e varfërisë mund të ndahen në tri kategori (Daring, 2008; Engël&Blek, 2008):

1. Strategji të orientuar drejt zvogëlimit të varfërisë familjare nëpërmjet **rritjes së të ardhurave** të familjeve të varfra e me këtë edhe përmirësimin e mirëqenies psikologjike të fëmijëve.

Dëshmi nga studimet për lëvizshmërinë ekonomike familjare tregojnë se të ardhurat familjare *perse* ndikojnë në investimin në fëmijët nga ana e familjes, proceset e stresit familjar, e me këtë edhe zhvillimi psikologjik të fëmijëve edhe se përmirësimi i mirëqenies ekonomike të familjeve të varfra rezulton me përmirësimin e mirëqenies psikologjike të fëmijët e varfra. Në SHBA plotësimi i të ardhurave dhe programet për ndryshimin e vendbanimit (zhvendosja e fëmijëve nga lagjet e varfra drejt ato të pasurat) rezultoi me përmirësime në arritjet akademike dhe mirëqenien e fëmijëve, por vlerësimi më shumë vjeçar tregojnë kompleksitetin dhe ndryshueshmërinë e efekteve të këtyre programeve (Engël&Blek, 2008).

2. Strategji të orientuara kah parandalimi i varfërisë dhe “investim në ardhmëri” dhe theksimi i rëndësisë së arsimit, siç janë përforcimi i stimulimit për të nxënë nëpërmjet arsimit parashkollor me kualitet më të lartë, përmirësimin e aftësive të prindërve që ta mbështetin të nxënit e hershëm të fëmijëve, përmirësimin e kompetencave profesionale të mësimitdhënësve etj.

a) Përmirësimi i përgatitjes për shkollë: ndikimi i programeve parashkollore të kualitetit të lartë.

Vlerësimi i efekteve nga përmirësimi i përgatitjes për shkollë nëpërmjet programeve parashkollore të kualitetit të lartë në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim theksojnë se përvojat parashkollore të kualitetit të lartë (të kombinuara me përfshirjen e prindërve dhe përmirësimin e gjendjes shëndetësore) mund të kenë ndikim të dukshëm në gjuhën dhe shkathtësive njohëse (kognitive) të fëmijët të moshës deri në 5 vjet (Engël&Blek, 2008). Studimet longitudinale të programeve intensive për intervenim të hershëm siç është projekti parashkollor *Perry* (Shvajnhart e tjerë, 2005) dhe projekti *Abecedarian* (Kembell e tjerë, 2002) theksojnë se fëmijët të cilët kanë marr pjesë në programet kanë pasur gjasa më të mëdha të mbarojnë shkollim të mesëm, të studiojnë, të gjejnë punë dhe të kenë sigurim shëndetësor si dhe gjasa më të vogla për procedura kundërvajtëse ose simptoma depresioni (Rejnolds e tjerë, 2007).

b) Strategji gjithëpërfshirëse të cilat e avancojnë zhvillimin e fëmijëve para regjistrimit në shkollë.

Qëllimi i strategjive gjithëpërfshirëse është përballimi me pasojat e shumëfishta të gjendjes së pavolitshme në përpjekjet për përmirësimin e zhvillimit dhe arritjeve arsimore të fëmijëve. Programi *Early Head Start* është shembull i shkëlqyeshëm i programit për intervenim të hershëm i cili ka për qëllim avancimin e përgatitjes për shkollë dhe parandalimin e pasojave negative nga varfëria në arritjet arsimore të fëmijët nën moshën tre vjeçare. Vlerësimi i paradokohshëm i hulumtimit në 3001 familje sipas zgjidhjes së rastit tregoi se deri në moshën tre vjeçare, fëmijët që kanë marr pjesë në programin *Early Head Start* kanë qenë më mirë të përgatitur për kopshtin e fëmijëve sesa fëmijët e grupit të kontrollit për sa i përket zhvillimit të tyre njohës dhe gjuhësor, përfshirjes emocionale të prindërve, vëmendjes e cila tërhiqet me lodra, dhe shkallëve të ulëta të sjelljes agresive (Lov e tjerë, 2005, faq. 50). Përveç kësaj prindërit e fëmijëve që kanë marr pjesë në intervenim treguan mbështetje më të madhe emocionale, më lehtë janë shprehur, kanë kaluar më shumë kohë duke u lexuar fëmijëve, më pak i kanë goditur fëmijët e tyre në krahasim me grupin e kontrollit të prindërve. Këto gjetje e mbështesin rëndësinë e inkuadrimin të prindërve në aktivitetet dhe

në intervenim dhe të matjes së ndikimit të aktiviteteve në sjelljen e tyre dhe praktikave prindërore (Engël&Blek, 2008, faq. 250).

c) Përmirësimi i kapaciteteve të familjes për mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve dhe arritjeve akademike: programi për edukimin dhe mbështetjen e prindërve.

Qëllimi i programeve për edukim dhe mbështetje të prindërve dhe zbutjen e pasojave negative të varfërisë në karakteristikat e familjes që të përmirësohet mirëqenia e fëmijëve. Këto programe realizohen nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm, duke përfshirë qendrat ose sistemet shëndetësore, vizitat në shtëpi nga punëtor të trajnuar, kombinim të këshillimeve me ndjekjen e rritjes, organizimit të sesioneve në grup me prindërit dhe programe në media (Engël&Blek, 2008, faq. 249). Numri i madh i studimeve e tregojnë lidhjen mes ndryshimit të qëndrimeve dhe praktikave të prindërve dhe zhvillimit njohës (kognitiv) dhe socio – emocional të fëmijëve (Suit&Apelbam, 2004). Por u ngrit çështja a vlen të paguhen programet për vizita në shtëpi të dedikuara për edukimin dhe mbështetjen e prindërve sepse u tregua se rezultatet e drejtpërdrejta dhe ato indirekte të këtyre programeve nuk mund t'i arsyetojnë shpenzimet. Studime të tjera zbulojnë se vizitat në shtëpi dhe intervenimet tjera për prindërit nuk janë të mjaftueshme kur janë në pyetje familjet me resurse të pakta dhe se duhet qasje më gjithëpërfshirëse (Gombi, Kulors&Behrman, 1998).

Intervenimet në disa vende në zhvillim të cilat u treguan efektive kanë zbatuar të mësuar të bazuar në aktivitete (me mundësi aktivitetet të mësohen në vend që vetëm të realizohen) dhe demonstrim në vend vetëm të diskutimit, qoftë nëpërmjet vizitave në shtëpi, qoftë nëpërmjet sesioneve në grup me edukator/kujdestar (Engël&Blek, 2008).

ç) Forcimi i mësimitdhënësve nëpërmjet ndërtimit të kapaciteteve profesionale të tyre për ballafaqim me pabarazinë në arsim.

Programet për zhvillim profesional të mësimitdhënësve janë të orientuara drejt arsimit për të drejtë sociale dhe strategji të cilat mësimitdhënësit mund t'i zbatojnë që të krijojnë kontekst arsimor të lirë nga paragjykimet dhe shtypja (opresioni). Pol Gorski (2013) e fut konceptin e mësimitdhënësit “të aftësuar për barazi” (equite-literate) i cili posedon njohuri, shkathtësi dhe vlera të cilat i ka të rëndësishme që të ballafaqohet me diversitetin në atë mënyrë që t’ju mundësojë të gjithë nxënësve t’i zhvillojnë potencialet e tyre të tërësishme. Mësimitdhënësi i aftësuar në këtë mënyrë posedon aftësi për identifikim të paragjykimeve dhe mekanizmave të ndryshëm (në mënyrë implicite apo eksplicite) të cilat e mbajnë sistemin e pabarazisë në nivel të klasës/shkollës, politikave arsimore dhe shoqërisë në tërësi. Mësimitdhënës kompetent duhet të dijë të njeh kur mbahet ana, të njeh paragjykimet dhe praktikën shtypëse (opresive) në kurrikul, në materialet mësimore, metodat mësimore, librat shkollor, metodat e notimit të nxënësve e kështu me radhë. Mësimitdhënësi “i aftësuar për barazi”, sipas Gorskit, duhet të dijë të përgjigjet në paragjykimet dhe në pabarazinë në mënyrë e cila do t’ju ndihmojë nxënësve dhe mësimitdhënësve të tjerë të identifikojnë paragjykimet dhe praktikën shtypëse (opresive) të ndryshme dhe t’i përfshijë në bisedë rreth çështjes si praktikën e tilla manifestohen nëpër materialet mësimore dhe në librat shkollor, ndërveprimet në klasë dhe politikën e shkollës. Aftësia për ballafaqim me paragjykimet dhe pabarazinë në afat të gjatë dhe për parandalimin e paraqitjes së

sërishme në klasa dhe në shkolla është gjithashtu një kompetencë e rëndësishme e mësimdhënësit. Mësimdhënësit duhet të dinë të përkrahin dhe të mbrojnë praktika shkollore të barabarta dhe të drejta, të zbatojnë qasje të ndryshme në mësimdhënie për “izmat” e ndryshëm dhe vazhdimisht të bëjnë vetë reflektim dhe vlerësim të praktikave të veta dhe ndikimin e tyre mbi nxënësit. Aftësia për krijimin dhe mirëmbajtjen e mjedisit të barabartë të të nxënësve për të gjithë nxënësit pa paragjykimet të cilët nxisin ndërveprim social dhe pjesëmarrje aktive në procesin e të nxënësve nuk është detyrë e lehtë, veçanërisht nëse merret parasysh se paragjykimet dhe kuptimi i kufizuar i identitetit janë të rrënjësor në funksionimin njohës (kognitiv), social dhe emocional dhe se shoqëritë në të cilat jetojmë nxisin konkurrencën dhe e mbajnë gjallë idenë e pabarazisë në nivele të ndryshme të shumta (Vranjesheviç, 2012). Aftësia për vendosje të rrethit pjesëmarrës, inkluziv dhe të sigurt të të nxënësve nënkupton që mësimdhënësit të vendosin pritje të larta për të gjithë nxënësit nëpërmjet pedagogjisë dhe kurrikulës me kualitet të lartë; të kuptojnë se nxënësit kanë qasje të ndryshme në resurset dhe të krijojnë klasë në të cilën të gjithë nxënësit në mënyrë të lirë mund të shprehin lirshëm dhe në mënyrë të sigurt (Gorski, 2013).

**3.** Strategji të cilat synojnë t'i kundërshtojnë praktikat institucionale shtypëse (opresive) dhe t'i inkurajojnë njerëzit e varfër.

Sipas disa hulumtues dhe bartësve të politikave, as arsimit as rritja ekonomike nuk janë strategji e mjaftueshme kur është në pyetje zvogëlimi i varfërisë. Që një strategji të jetë e efikase, është e nevojshme qasje gjithëpërfshirëse e cila do të përfshijë inkurajimin e njerëzve të varfër “që të mund të marrin pjesë në rritjen ekonomike e cila kërkon investim në shëndetësi, arsim dhe mbrojtje sociale, si edhe ndërtim të institucioneve të cilat do t’ju mundësojnë të marrin pjesë në vendimet të cilat e formojnë jetën e tyre” (Stern, 2003 sipas Engël&Blek, 2008). Intervenimi gjithëpërfshirës duhet t'i kundërshtojë praktikat institucionale shtypëse të cilat ua ndalojnë pjesëmarrjen grupeve të marginalizuara dhe të kërkojnë mundësi më të hapura për forcimin e veprimit individual dhe kolektiv (Engël&Blek, 2008). Intervenimi gjithëpërfshirës njëkohësisht e përfshin çështjen e proceseve vepruese të ndërmjetësuar, të moderuara të cilët e lidhin varfërinë dhe zhvillimin e fëmijëve. Sipas Fullanit (1991), që të shkaktohet ndryshim, është i nevojshëm re-kulturizim, gjegjësisht ndryshim të qëndrimeve, vlerave dhe perspektivave dominuese dhe ri strukturim, gjegjësisht ndryshim të sistemit që të mbështes ndryshim të qëndrimeve dhe të mund të mirëmbahen. Kjo do të thotë se është e nevojshme të punohet shumë dhënë mënyrë sistematike në ndryshimin e praktikave institucionale shtypëse në arsim dhe në shoqëri me qëllim që të krijohen kushte fëmijët/njerëzit që janë të rrezikuar nga varfëria të marrin një rol më aktiv në vendimet të cilët e formojnë jetën e tyre.

## ▶ 2. BALLAFAQIMI ME PABARAZINË SOCIO – EKONOMIKE NË SHKOLLË

*Detyrë e edukatorëve është t'i mësojnë nxënësit ta shohin vitalitetin në vete.*

*Xhosef Kembel*

Hulumtimet e theksuar në kapitullin e mëparshëm i tregojnë pasojat dëmtuese të varfërisë në zhvillimin socio – ekonomik dhe arritjeve në shkollë të nxënësve.

Shkolla luan rol kryesor në zhvillimin socio – emocional të të rinjve veçanërisht të të rinjve që janë të rrezikuar. Arritjet arsimore të nxënësve varen çështja si ato ndjehen në shkollë – hulumtimet tregojnë se përveç vetë arsimit, mjedisi social në mënyrë plotësuese kontribuon për arritjet arsimore (Proser 1999, sipas Vukoviç Vidaçiç, 2016).

A do të jetë shkolla **rrezik faktor** – vend ku fëmijët dhe të rinjtë janë të izoluar, të diskriminuar, ku zhvillojnë probleme të reja shtesë në sjellje, sillen në mënyrë agresive ose tërhiqen dhe bëhen pasiv dhe depresiv? ose do të jetë **mjedisi i sigurt**, vend ku fëmijët dhe të rinjtë mbështeten që t'i zhvillojnë kompetencat e tyre, të mësojnë si të menaxhojnë emocionet e tyre të njoftohen, të zhvillojnë vetëbesim, vetë respektim dhe përgjegjësi personale, të mësojnë të komunikojnë në mënyrë të sigurt dhe të shprehin dhe të realizohen në mënyrë kreative? (Pavloviç e tjerë, 2017). Kjo varet nga vlerat, bindjet, shprehitë dhe sjelljet e përbashkëta t'i cilët i shkëmbejnë të gjithë palët e interesuara (të punësuarit në shkollë, nxënësit dhe prindërit) të cilët së bashku do të punojnë në zhvillimin e klimës pozitive në shkollë e cila drejtpërsëdrejti ndikon në mirëqenien e nxënësve.

Raporti botëror mbi lumturinë dhe mirëqenien (Helivel e tjerë, 2015, sipas Pavloviç e tjerë, 2017) tregojnë se shkollat që si prioritet kanë mirëqenien e nxënësve, kanë potencial të bëhen më efikase, kurse nxënësit e tyre të kenë arritje më të mira në arsim dhe në përgjithësi në jetë. “Lumturia, mirëqenia dhe angazhimi i fëmijëve dhe të rinjve varet nga udhëheqja, mbështetja dhe kuptimi nga të rriturit. Në kontekstin e shkollës, udhëheqja demokratike e bazuar në respektimin e dallimeve, interkulturës, të drejtat njerëzore, forcimi dhe angazhimi i nxënësve, të punësuarve dhe palëve të tjera të interesuara në zhvillimin e roleve të ndryshme që i luan shkolla, paraqet bazë për punë kualitative në dobi të çdo individi (jo vetëm të nxënësve, por edhe të punësuarve, prindërve dhe bashkësisë vendore)” (Pavloviç e tjerë, 2017).



## A duhet të priten reformat shkollorë dhe kushtet më të mira financiare, apo shkollat mund të fillojnë të krijojnë klimë pozitive shkollorë që sot?

Edhe pse sistemet arsimore në vende të ndryshme nuk i plotësojnë parakushtet e njëjta të obligueshme për punë të shkollës, hulumtimet të realizuara në Estoni vërtetojnë se kushtet e nevojshme për klimë pozitive shkollorë janë universale dhe pa pagesë dhe se varen nga bashkëpunimi mes të gjithë palëve që marrin pjesë në jetën e një shkolle, veçanërisht nxënësit.

Dëshmitë nga Estonia tregojnë se **bashkëpunimi** mes udhëheqjes së shkollës, mësimitdhënësve, prindërve dhe nxënësve paraqesin vlerë. Mësimitdhënësit në Estoni në mënyrë aktive angazhohen t'i njoftojnë familjet e nxënësve të tyre, veçanërisht në fillim të rrugës arsimore të tyre: Janë të bindur se marrëdhënie mes nxënësve dhe të punësuarve në shkollë janë shumë të rëndësishme. Përveç kësaj prindërit janë të përfshirë në punën e shkollave nëpërmjet mbledhjeve në të cilat bisedojnë për planet e përgjithshme për të ardhmen e shkollës, që është shumë e rëndësishme për nxënësit me SES të ulët sepse në atë mënyrë ulët largimi nga shkolla (School Education Gateway, 2015). Në rast se nxënësit kanë probleme, shërbimet për mbështetje, punëtorët social, mësimitdhënësit dhe koordinatorët bashkëpunojnë që t'i zgjidhin problemet e nxënësve.

Në kuadër të bashkëpunimit mes të gjithë palëve të interesuara, është me rëndësi që nxënësve t'u mundësohet t'i shprehin idetë dhe dëshirat e tyre që kanë të bëjnë me jetën dhe rregullat në shkollë, që mund të organizohet nëpërmjet inkuadrimin të tyre në **drejtimin me shkollën**. Në rastin e shkollave në Talin, unioni i nxënësve ka ndikim të madh dhe është bashkëbisedues i rëndësishëm gjatë sjelljes së vendimeve. Për shembull, ata vunë "veto" për dokumentin e zhvillimit shkollor i cili nuk kishte paraparë meny vegjetarianë në kantinën e shkollës. Përveç kësaj, nxënësit mund t'u ndihmojnë mësimitdhënësve në mësimitdhënie dhe t'i shfrytëzojnë dhe t'i përmirësojnë kompetencat e tyre në fusha të ndryshme. Të rinjtë që perceptojnë kompetencat e tyre ndoshta mendojnë se janë të aftë të ndryshojnë diçka në vete ose në mjedisin e tyre nëse është në pyetje një qëllim i dëshirueshëm; kjo mund të forcojë aftësinë ripërtëritëse dhe përshtatjen e tyre në ndryshimet jetësore (Sharp, 2014). Kjo ndjenjë mund t'ju ndihmojë nxënësve ta forcojnë angazhimin e tyre në zhvillimin personal dhe me bashkësinë (Uelcel&Ingelhart, 2010), që mund ta përmirësojë mirëqenien (Seliman, 2011).

Nxënësit mund të kontribuon në jetën shkollorë dhe në ndërtimin e klimës pozitive shkollorë nëpërmjet pjesëmarrjes në **aktivitete jashtë mësimore** të ndryshme (në tekstin e mëtejshëm AJM). Aktivitetet e tilla duhet të dalin nga vet nxënësit, sipas interesave të tyre. Aktivitetet vullnetare duhet të jenë të lidhura me problemet të cilat nxënësit i identifikojnë, a edhe vet aktivitetet duhet të jenë të propozuara nga nxënësit. Estonia i jep mirënjohje rëndësishme së aktiviteteve jashtë mësimore me atë që në çdo shkollë ka të punësuar menaxher profesional për aktivitete të lira.

Studime të shumta hulumtuese tregojnë se nxënësit kanë përfitime nga pjesëmarrja në AJM, duke përfshirë vet respekt më të lartë dhe aftësi ripërtëritëse si dhe shkallë më të ulët të depresionit (Frederik&Ekël, 2006), shkallë më të ulët të largimit nga shkolla, delikuencë e zvogëluar dhe shkallë më të ulët të keqpërdorimit të drogës (Mahoni&Kamis, 1997). Pjesëmarrja në AJM është e lidhur me rezultate më të mira akademike, nota dhe pikë më të larta në teste, angazhim në shkollë dhe aspirata

arsimore (Ekël&Barber, 1999). Zaf e tjerë (2003) pohojnë se nëpërmjet pjesëmarrjes në AJM të strukturuar, të rinjtë hulumtojnë në se janë të mirë dhe kështu e forcojnë ndjenjën e tyre se janë të vlefshëm; njëkohësisht ndërtojnë raporte të rëndësishme mentoriale me të rriturit, që së bashku siguron mjedis të volitshëm për rritje. Feldman&Matjasko (2005) pohojnë se pjesëmarrja në AJM është mikrosistem i vetëm të cilin të rinjtë e zgjedhin vet sepse përputhet me nevojat dhe talentet e tyre, si dhe se kjo përputhje mund të jetë me rëndësi të veçantë nëse nevojat e të rinjve nuk janë të kënaqur në mikrosistemet e tjerë. Kjo veçanërisht është e rëndësishme për nxënësit me SES të ulët për të cilët ekziston rrezik më i madh për largim nga shkolla, pjesëmarrja e tyre në AJM ndoshta është pjesa e vetme në kontekstin shkollor ku ndjehen kompetent.

Aktivitetet jashtë mësimore ndihmojnë të krijohet ose të mbahet klima pozitive shkollorë sepse hapin mundësi për bashkëpunim mes palëve të interesuara, krijojnë raporte të afërta dhe mbështetje dhe zhvillim të identitetit, vlerave, qëndrimeve dhe sjelljeve të përbashkëta shkollorë.

Në vazhdim janë paraqitur tekste me shembuj të praktikave të mira nga shkollat që marrin pjesë në projektin BRAVEdu por edhe i shkollave tjera të cilët kultivojnë klimë pozitive shkollorë nëpër projekte të ngjashme.<sup>1</sup> Këto shkolla realizojnë aktivitete të cilat u mundësojnë nxënësve të bëhen subjekte aktive mendimet e të cilëve janë relevante, kurse diversiteti pranohet dhe bashkëpunimi mbështetet. Përveç kësaj, këto shkolla e kanë kuptuar sa është e rëndësishme të përfshijnë prindërit dhe tërë bashkësinë në punën e tyre. Mësimitdhënësit, nxënësit dhe prindërit bëhen partner të cilët kontribuojnë në zhvillimin e shkollës së lumtur, ku nxënësit realizojnë arritje më të mira akademike dhe jetësore.

Në këto shembuj nuk etiketohen nxënës të caktuar si nxënës me status të ulët socio – ekonomik, por nëpërmjet realizimit të aktiviteteve me të gjithë nxënësit, të atyre me SES të ulët u ndihmohet të ndjehen të pranuar, të njohin dhe t'i zhvillojnë kompetencat e tyre dhe njëkohësisht jep mundësi t'u ndihmojnë të tjerëve.

Përfaqësuesit e shkollave estoneze tregojnë se nuk përdorin strategji të veçanta me nxënësit me SES të ulët, por se mbajnë klimë shkollorë e cila karakterizohet me ofrimin e mbështetjes – në të cilën është i rëndësishëm zëri i çdo nxënësi, ku nxënësve u ndihmohet t'i njohin dhe t'i zhvillojnë kompetencat e tyre, të njohin vetveten, të zhvillojnë vet respekt, t'u ndihmojnë të tjerëve dhe të mësojnë njëri nga tjetri, gjegjësisht të zhvillojnë mjedis i cili kontribuon për zhvillimin e potencialit të tërësishëm dhe arritje më të mira akademike për të gjithë nxënësit.

<sup>1</sup> <https://startthechange.net/>

## ▶ 2.1. KLASA DHE AKTIVITETE JASHTË MËSIMORE

### > Shkolla Fillore “Dane Krapçev” <

#### ▶ Ushqim i shëndetshëm për ardhmëri të shëndetshme

Shkolla fillore “Dane Krapçev” gjendet në afërsi të SOS Fshatit të fëmijëve në Shkup dhe pjesa më e madhe e fëmijëve nga SOS Fshati i fëmijëve mësojnë në këtë shkollë. Duke marrë parasysh faktin që në këtë shkollë mësojnë fëmijë me përkatësi të ndryshme fetare, etnike dhe sociale, shkolla ka organizuar aktivitete të shumta në të cilat qëllimi ka qenë t'i avancojnë raportet ndër personale mes nxënësit, ta ngrenë vetëdijen për ngjashmëritë mes tyre dhe ta përmirësojnë bashkëpunimin mes prindërve dhe shkollës. Një aktivitet i tillë e realizuar në muajt e fundit është përpunimi i temës ushqimi i shëndetshëm. E zgjodhëm këtë temë sepse është e rëndësishme për të gjithë fëmijët në shkollë, pa marr parasysh prejardhjen tonë të gjithë duhet të kemi qëndrim të njëjtë ndaj ushqimit të shëndetshëm dhe shprehive për të ushqyerit e shëndetshëm të fëmijët.

Të gjithë palët relevante (Ministria, drejtoresha e shkollës dhe prindërit) qenë të lajmëruar dhe qenë të konsultuar para se ta fillojmë këtë aktivitet. Me qëllim që të mbulohet i tërë procesi si fitojmë ushqim nga fusha e deri te tryeza, nxënësit realizuan vizita fushave të punuara dhe vizituan Fakultetin e Shkencave Bujqësore dhe Ushqim ku profesionist i njoftuan nxënësit për metodat e prodhimit të ushqimit të shëndetshëm. Nxënësit gjithashtu u njoftuan edhe me një fabrikë të suksesshme për prodhimin e ushqimit të shëndetshëm në Shkup dhe e vizituan tregun e afërm që të fitojnë njohuri për tërë ciklin e prodhimit dhe shitjes së ushqimit.

Mësimdhënësit dhe nxënësit siguruan prodhime ushqimore, donacione të ushqimit si dhe së bashku përgatitën shujtë të shëndetshme në shkollë. Që të njoftohen me rrethinën ku jetojnë disa nga shokët e klasës, të gjithë fëmijët e vizituan SOS Fshatin e fëmijëve ku u organizua një vakt i përbashkët për të gjithë, aktiviteti u emërua “Mysafirë në shtëpinë e miqve tanë”. Të gjithë nxënësit dhe mësimdhënësit mbanin bluza të njëjta me çka dërguan porosi se pa marrë parasysh ku jetojmë dhe nga e kemi prejardhjen, të gjithë kemi dëshira dhe aspirata të njëjta, ndër të cilat më e rëndësishme është që të mundemi të mësojmë, të shoqërohemi me miqtë dhe të jemi të pranuar dhe të lumtur.

Si rezultat i këtij aktiviteti, sipas mësimdhënësve, u përmirësua socializimi dhe shoqërimi mes nxënësve të shkollës. U shpeshuan aktivitete si për shembull vizita e shtëpive të shokëve, përgatitja e projekteve të përbashkëta, kryerja e detyrave të shtëpisë dhe organizimi i festimeve të përbashkëta. Përsëri kësaj, indikator i mirë për ndikimin e këtij aktiviteti është fakti që nxënësit vazhdimisht iniciojnë dhe kërkojnë të marrin pjesë në aktivitete të ngjashme.

*Që të nxiten raporte më të mira mes nxënësve me prejardhje të ndryshme sociale, mësimdhënësit zgjodhën tema dhe aktivitete në të cilat mund të kyçen një numër më i madh i nxënësve pa marrë parasysh klasën, interesat ose arritjet arsimore. Në këtë mënyrë, ata kontribuuan për krijimin e raporteve më të mira sociale mes nxënësve, si dhe mes nxënësve dhe mësimdhënësve, që është parakusht kyç për mjedis shkollor i cili i mbështet dhe kujdeset për fëmijët.*

*SOS Fshati i fëmijëve përkujdeset për nxënës pa kujdes prindëror dhe fëmijë të familjeve nën rrezik – diversiteti për të cilin nxënësit janë të vetëdijshëm dhe të cilët thjeshtë janë burim i paragjyqimeve. Nëpër këto aktivitete, nxënësit fituan njohuri për dallimet mes vete dhe ndërtuan vetëdije për karakteristikat të cilat janë të përbashkëta dhe të cilat ata ndajnë e të cilat janë të rëndësishme për formimin e jetës së përditshme shkollore.*



## > Shkolla fillore "Tishina" <

Shkolla fillore sllovene "Tishina" punon në vendosjen e atmosferës për mbështetje, shkëmbim të njohurive dhe shkathtësive mes nxënësve të moshës së ndryshme dhe mësimdhënësve të tyre.

### ▶ Ndërmjetësim (Mediacion) mes nxënësve

Kjo shkollë fillore e praktikon ndërmjetësimin si metodë e zbatueshme për zgjidhjen e konflikteve mes nxënësve dhe mundësi që nxënësit të mësojnë t'i pranojnë dallimet, mendimet dhe raportet mes tyre. Kështu, ata marrin përgjegjësi për zgjidhjen e konfliktit, pa ndërhyrjen e të rriturve të cilët mund të sjellin gjykim për fajin e ndonjërit.

Pasi që mësimdhënësit kaluan edukim për ndërmjetësim, e prezantuan përmbajtjen e seminarit para kolegëve të tyre. Pastaj, përmbajtjet nga seminari ua prezantuan nxënësve, prindërve të tyre, e disa nxënës u bënë ndërmjetësues të rinj të cilëve shokët e klasës mund t'ju drejtohen në rast të paraqitjes së ndonjë problemi. Mësimdhënësit veçanërisht janë krenar që nxënësit nuk e përdorin ndërmjetësimin vetëm për zgjidhjen e konflikteve, por i përdorin teknikat e saj, siç janë të dëgjuarit aktiv, njohja e emocioneve dhe nevojave si dhe gjetjen e zgjidhjeve të përbashkëta në jetën e përditshme. Nxënësit dinë se ndërmjetësi mund t'ju ndihmojë të zgjidhin ndonjë problem, por ata mësojnë që vetë t'i zgjidhin problemet pa intervenim të personit të tretë. "Duket interesante të zgjidhet grindja në mënyrë paqësore" dhe "Nuk jam tolerant sa duhet" – janë disa nga komentet e nxënësve të cilët shfaqin dëshirë për ndryshim dhe ndërmarrje të iniciativave për zgjidhjen e konfliktit.



*Zbatimi i ndërmjetësimit mes nxënësve në shkolla e ul dhunën, vandalizmin dhe përjashtimin si dhe kontribuon për zhvillimin e qëndrimeve sociale pozitive dhe sjellje të fëmijët dhe të rinjtë. Nxënësit më lehtë e pranojnë shkollën si vend ku zhvillohet identiteti dhe vet respekti i tyre dhe mësohen që të jenë të pavarur jashtë familjes.*

*Duke marr parasysh se hulumtimet tregojnë se rritja në varfëri nxit probleme socio – emocionale siç janë agresiviteti dhe sjellja destruktive (Meklojd, 1998; Broks-Gan&Dankan, 1997; Tejlor, Daring&Mekkartni, 2004), zgjidhja e pa dhunshme e konflikteve dhe zhvillimi i shkathtësive të ndërmjetësimit mund t'ju ndihmojnë nxënësve me SES të ulët por edhe nxënësve tjerë të zhvillojnë raporte më të mira, më mirë të komunikojnë dhe të kuptojnë veten, ndjenjat dhe raportet e veta me të tjerat.*

### ▶ Kapma dorën dhe bëhu shoku im

Ky projekt që menduar me qëllim që nxënësit më të vegjël të ndjehen këndshëm në shkollë, kurse nxënësit më të rritur t'ju ofrojnë shoqërim dhe ndihmë gjatë të mësuarit, që do të sillte deri te adaptimi më i lehtë në mjedisin e ri. Hapi i parë ishte të gjenden nxënës të aftë të ofrojnë ndihmë ose nxënës të cilëve ju nevojitet ndihmë dhe të cilët janë të përgatitur që një ndihmë të tillë të pranojnë. Hapi vijues ishte formimi i çifteve të nxënësve, mësimdhënësit ndihmuan të formohen çiftet sipas nevojave të nxënësve. Për shembull, nxënësit me sukses të mirë në një lëndë të caktuar bashkohen me nxënës të cilët në lëndën e njëjtë u nevojitet ndihmë, kurse nxënësit e klasave më të larta të cilët nuk kanë sukses të shkëlqyeshëm apo shumë të mirë në lëndë të caktuar u ndihmojnë nxënësve të klasave më të ulëta me disa përmbajtje që nuk janë shumë komplekse. Ky projekt ndihmoi të zhvillohet lidhja dhe bashkëpunimi mes nxënësve të moshave të ndryshme, gjatë kësaj u ofrohet mundësia nxënësve më të vjetër, pa marrë parasysh arritjet e tyre shkollore, t'ju ndihmojnë të tjerëve. Kjo u mundësoi nxënësve t'i zhvillojnë kompetencat dhe vetëbesimin e tyre, duke mos e parë dhe vlerësuar veten gjatë kësaj vetëm në bazë të suksesit të tyre shkollor.

*Aktivitetet të tilla ndihmojnë të krijohet mjedis shkollor i cili karakterizohet me kujdes dhe mbështetje, e cila më me sukses tregohet në ndërtimin e raporteve mes nxënësve në shkolla me popullatë të madhe të goditur nga varfëria (Batstik e tjerë., 1995)*

*Hulumtime të shumta tregojnë se potenciali i nxënësve për sukses akademik rritet kur nxënësit i ndihmohet nëpërmjet bashkëpunimit në mësim, lidhjes me grupin dhe ndërtimit të respektit dhe besimit të ndërsjellë (Vukoviç Vidaçiç, 2016).*

### ▶ Jep dhe merr libër

Në shkollë u formua këndi **Jep dhe merr libër**, ku nxënësit mund të shkëmbejnë libra, të marrin libër që u duhet ose të dhurojnë libër i cili më nuk u duhet. Duke i falënderuar Këndit, nxënësit mësojnë të riciklojnë dhe më shumë herë të përdorin sende të vjetra – dhe për çudi – Nxënësit ishin të lumtur me librat e tyre "të reja" dhe të kënaqur sepse bënë diçka që i bëri të lumtur të tjerët, sqaroi mësimdhënësi – udhëheqës i projektit.



*Projekte si ky hapin mundësi t'u ndihmohet nxënësve me SES të ulët të cilët nuk kanë në dispozicion resurse materiale të përshtatshme. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, në ato nuk shihet si ndonjë të cilit i nevojitet ndihma, nuk i nënshtrohen stresit plotësues. Të gjithë nxënësit mund të sjellin ose të marrin diçka, secili ndjehet si pjesë e grupit anëtarët e së cilit shkëmbejnë materiale pa u parë cili ka marr diçka ose ka lënë diçka.*

*Aktivitet i ngjashëm u realizua në shkollën nr. 21 në Talin, Estoni. Mësimdhënësit dhuruan veshje solemne (fustan ose kostum) të cilët nxënësit mund t'i huazojnë që mos të duhen të blejnë veshje solemne për mbrëmjen e maturës. Të gjithë nxënësit huazojnë veshje e jo vetëm nxënësit me SES të ulët.*

*Në shkollën fillore Vinko Zhganec, nxënësit prodhojnë gjëra të ndryshme dhe i shesin në ekspozita. Me ato të holla blihen pajisje të ndryshme (materiale) të nevojshme për punë në orët e mësimin (ngjyra, gërshtë, fletore...). Bëhet fjalë për materiale të zakonshme, nxënësit i huazojnë dhe i kthejnë pas orës. Në këtë mënyrë të gjithë nxënësit kanë qasje në materiale të ndryshme, që është shumë e rëndësishme për ata me SES të ulët.*

## > Shkolla fillore Dr. Vinko Zhganec <

Në këtë shkollë kroate, nxënësit dhe mësimdhënësit së bashku mendojnë aktivitetet dhe projekte të ndryshme dhe e shfrytëzojnë çdo rast për përfshirjen e prindërve dhe bashkësisë vendore. Duke marr parasysh faktin se në këtë shkollë mësimin e ndjekin nxënës rom, pjesë e madhe e projekteve janë përqendruar në njohjen e kulturës romë dhe ballafaqimin me paragjykimet.

### ▶ *Etno libër i ilustruar i klasës sonë*

*Etno libri i ilustruar i klasës sonë* përgatitet nga nxënësit dhe mësimdhënësit e tyre. Kjo ka për qëllim që t'ju ndihmojë nxënësve të zhvillojnë kërkimi të njoftohen kultura tjera dhe të mësojnë për festat në familjet me përkatësi të ndryshme fetare, që më mirë të njoftohen njëri me tjetrin si dhe me familjet e shokëve të klasës. Prindërit janë të ftuar të kontribuojnë në krijimin e librit të ilustruar nëpërmjet fotografive familjare, nxënësit shënojnë si rrjedhin festat si dhe plotësohet pyetësor me të dhënat e nevojshme për procesin e krijimit të librit të ilustruar. Materialet e mbledhura në librin e ilustruar prezantohen në ekspozitën e shkollës dhe të gjithë nxënësit e shpërndajnë në shtëpi si dhuratë dhe rikujtim të një procesi të këndshëm të mësimin dhe shoqërimin.

Me qëllim që prindërit të vijnë në shkollë, të shoqërohen me nxënësit dhe mësimdhënësit si dhe më mirë të njoftohen, qenë ftuar të vijnë në ditën e hapur të shkollës që t'i tregojnë lojërat që i kanë lozur si fëmijë, të luajnë në një instrument tradicional ose të prezantojnë ose ushtrojnë me nxënësit këngë tradicionale... "Më e rëndësishme është të vendoset bashkëpunimi me prindërit, në hollësi të shpjegohen të gjitha aspektet dhe të tejkalohen frikët dhe turpi të disa prindër" theksoi njëri nga mësimdhënësit i cili i udhëhiqte aktivitetet.

Krijimi i librit të ilustruar i gëzoi pjesëmarrësit: nxënësit, prindërit, gjyshet dhe gjyshërit punuan së bashku duke mbledhur materiale për librin e ilustruar, kurse nxënësit kërkeshin me prindërit dhe kontributin e tyre; prindërit deklaruan se ky projekt i ka kthyer në fëmijëri, si dhe gjatë prezantimit të librave të ilustruar dukshëm ishin të kënaqur me rezultatin e punës së lodhshme të tyre! Nxënësit i njoftuan shokët e klasës dhe prindërit e tyre, e veçmas ishin të kënaqur që e kuptuan diversitetin në klasë si një gjë e cila duhet të respektohet dhe të rruhet.

*Ky aktivitet ndihmoi që prindërit të ndjehen tumirë se ardhur në shkollë, që i zmadhoi gjasat që më shpesh të vijnë dhe të bëhen pjesë e jetës së shkollës së fëmijëve të tyre. Kjo kontribuon në ndërtimin e ndjenjës për kujdes dhe klimë shkollë të bazuar në mbështetjen dhe kënaqjen e nevojave të shfrytëzuesve e cila është e bazuar në bashkëpunim mes të gjithë palëve të interesuara, që veçanërisht është me kujdes për nxënësit me SES të ulët (Batstik e tjerë., 1995).*

*Përfshirja e prindërve e ul shkallën e largimit të hershëm nga arsimit e cila është shumë më e shpeshtë te nxënësit me SES më të ulët (School Education Gateway, 2015).*



Из наших крајина: Срби на Вањке, у Хрватској.



### ▶ Prindërit mësojnë të shkruajnë dhe të lexojnë

Gjatë takimeve individuale, disa nëna rome deklaruan se duan të mësojnë të lexojnë dhe të shkruajnë që të munden t'ju ndihmojnë fëmijëve të tre gjatë të nxënimit. Mësimdhënësit menjëherë u angazhuan dhe pas lejes së dhënë nga drejtori u organizua mbledhje prindërore ku u ftuan prindërit tjerë të bashkohen. Nga prindërit e interesuar u kërkua të japin pëlqim me shkrim dhe u kërkuan mësimdhënësit që do t'ju ndihmonin prindërve në bazë vullnetare. Qëllimi afatgjatë ishte të përfshihen edhe fëmijët të cilët do të ushtronin së bashku me prindërit e tyre lexim dhe shkrim dhe së bashku do të mësonin dhe do të shoqëroheshin.

*Shpesh mendohet se disa prindër nuk janë të interesuar për arsimimin e fëmijëve të tyre (Gorski, 2008), por duhet të dimë se jo çdo prind ka pasur mundësi të njëjta për arsimimin dhe nuk ndjehen të mirë se ardhur në shkollë e as që mund t'ju ndihmojnë fëmijëve të tyre në të nxënimit sepse vet nuk dinë të lexojnë dhe nuk dinë të shkruajnë.*

### ▶ Projekt ditor – mësimi i gjuhës rome

Duke pasur parasysh paragjykimet e shumta për fëmijët rom, mësimdhënësit e kësaj shkolle u përpoqën të gjejnë mënyrë të gjithë nxënësit të njoftohen me kulturën dhe gjuhën e romëve. Një ditë shkollore u kushtua mësimi të kulturës së romëve, kurse nxënësit rom e morën rolin e mësimdhënësve. „Ishte me rëndësi të njoftohen të gjithë prindërit me aktivitetin e planifikuar dhe të sigurohet pëlqimi i tyre. Për fat të keq, disa prindër nuk e kuptojnë mënyrën e tillë të punës dhe ju duhen sqarime plotësuese pse është e nevojshme të bëhet një projekt i tillë ditor“.

Në këtë aktivitet u përfshinë prindërit rom të cilët ndihmuan në planifikimin e përmbajtjes së ditës dhe përpilimit të fjalive në gjuhën rome. Ky aktivitet ndihmoi që prindërit rom të përfshihen në aktivitetet shkollore, kurse mësimdhënësit deklaruan se me atë që e morën rolin e mësimdhënësve nxënësit rom e përmirësuan vetëbesimin e tyre të nevojshëm për socializimin dhe punën e mëtejshme, treguan kënaqësi dhe krenari për kulturën dhe gjuhën e tyre, si dhe ndjenë se gjithashtu janë të aftë të japin njohuri. „Fëmijët mësuuan se shokët e tyre të klasës rom flasin dy gjuhë, kuptuan pse nxënësit rom e kanë vështirë ta flasin gjuhën kroate – për ata gjuha kroate është gjuhë e huaj sikurse gjuha angleze“ deklaroi një mësimdhënësi. Dita e kushtuar kulturës rome mbaroi me një këngë rome që mund të shihet në lidhjen vijues <https://youtu.be/N1M7-P4UYoI>

*Gorski (2008) pohon se nxënësit e grupeve të marginalizuara zakonisht nuk përshtaten në fotografinë e mësimdhënësit për nxënësit ideal dhe mësimdhënësit janë të prirë nxënësit e tillë t'i shohin në raport me dobësitë e tyre dhe të kenë pritje më të ulëta nga aftësitë e tyre për arritje.*

*Të gjejmë mënyrë t'ishfrytëzojmë nxënësit si ekspert, veçanërisht nxënësit e grupeve të marginalizuara, sepse kështu nxënësit do të ndjejnë se mund të kontribuojnë dhe të ndikojnë në rrethinën e tyre, kjo ndjenjë mund t'ju ndihmojë që të angazhohen më seriozisht rreth zhvillimit personal.*

## > Shkolla fillore "Motovun" <

Shkolla fillore "Motovun" mendon se është me rëndësi që nxënësit të mësojnë të jenë qytetar aktiv që nga mosha më e re.

### ▶ Bëhu shoku im

Ky projekt është zhvilluar në bashkëpunim me Shtëpinë për të rritur *Motovun*, e vendosur në komunën Motovun dhe kryesisht kujdeset për të rritur me probleme mentale.

Si tregon edhe vet emërtimi i projektit, qëllimi ishte zhvillimi i miqësisë mes nxënësve dhe banorët të Shtëpisë për të rritur *Motovun* nëpërmjet aktiviteteve.

Nxënësit marrin pjesë në punëtori të ndryshme së bashku me banorët e shtëpisë gjatë kësaj kryejnë aktivitete të dobishme për tërë bashkësinë. Aktivitetet përfshinin: mbledhje të gjetheve dhe kryerjes së aktiviteteve të kopshtarisë rreth Shtëpisë, përgatitja e reçeleve së bashku, dekorim të Shtëpisë për festat e kërshëndellave, krijimi i karteleve dhe dekorimeve, ndihmonin në kujdesen për kafshët dhe shëtitjeve të përbashkëta si dhe shoqërim në përgjithësi. Punëtoritë që mbaheshin në shkollë i përfshinin të gjithë nxënësit për shembull në krijimin e stolit dhe masës nga paletat e drurit, ngjyrosja e gomave, lojëra në natyrë ("lojëra shkollore" dhe Tvister), vendosja e luhatësve dhe pajisjeve tjera përkatëse në oborrin e shkollës si dhe shoqërim. Nxënësit zhvilluan ndjenjë të veprimit dhe përkushtimit për përmirësimin e bashkësisë vendore, për kontributin për pranimin dhe vet respektimin e njerëzve të cilët shpesh përkrahin të pranuar për shkak të paditurisë dhe paragjytimeve.

Shpresojmë se këta nxënës do të kontribuojnë për ndryshimin e bashkësisë së tyre vendore, do t'i thyejnë stereotipat dhe me shembullin e tyre do të tregojnë si duhet të iniciohen ndryshimet pozitive në bashkësinë vendore, në vend dhe në botë.



*Më shumë hulumtime treguan se pjesëmarrja e nxënësve në aktivitete jashtë mësimore mund të kenë ndikim pozitiv për shembull në forcimin e vetëbesimit të nxënësve, aftësi ripërtëritëse dhe shkallë më të ulët të depresionit (Ekles&Barber, 1999; Frederik&Ekles, 2006; Mahoni dhe Statin, 2000), shkallë më të vogël të largimit nga shkolla, delikuencës së të miturve dhe keqpërdorimit të drogës (Mahoni&Karins, 1997; Junis e tjerë, 1997). Pjesëmarrja në aktivitete jashtë mësimore lidhet me arritje më të larta akademike, nota më të mira, angazhim në shkollë dhe aspirata më të larta arsimore (Ekles\*barber, 1999, Marsh&Kleitman, 2002).*

*Vullnetarizmi ndihmon në fitimin e përvojave dhe kompetencave të nevojshme dhe të dobishme për angazhim aktiv në shoqëri, zhvillim personal, mirëqenie. Vullnetarizmi e përmirëson vetëbesimin, shkathtësitë akademike dhe e lehtëson orientimin profesional (Rot, Pavloviç&Moriç, 2015). Njëkohësisht i përforcon ndjenjat e lumturisë, kënaqësisë nga jeta, vetëbesimin dhe ndjenjën e kontrollit mbi jetën personale, shëndetin fizik dhe depresionin (Thot&Hevit, 2001).*

*Këto rezultate janë veçanërisht të rëndësishme për nxënësit me SES të ulët. Nëse këto aspekte zhvilluese vihen në fokus, nxënësit me SES të ulët nuk e fillojnë arsimimin nga pozita e njëjtë filluese si shokët tjerë të klasës së mesme dhe shpesh nuk e marrin mbështetjen e duhur në të nxënësit.*

*Në këtë mënyrë, nxënësit me SES të ulët kanë mundësi të njëjtë t'ju ndihmojnë të tjerëve, e jo të jenë vetëm pranues të ndihmës; ashtu mësohen të angazhohen në bashkësi.*

## > Shkolla fillore "Trpinja" <

Shkolla fillore "Trpinja" me krenari e promovon moton e saj – "I pranojmë dallimet individuale dhe të gjithë nxënësit në përputhje me aftësitë e tyre" – dhe vazhdimisht punojnë me nxënësit ta ndjekin këtë moto dhe të sillen në këtë mënyrë ndaj të tjerëve.

### ▶ Mbështetje e shokëve të klasës në të nxënët

Edhe pse mbështetja e shokëve të klasës në të nxënët është çdoherë e mirë se ardhur dhe zhvillohet në shumë shkolla, shpesh gabimisht mendohet se duhet ta udhëheqin nxënësit e shkëlqyeshëm. Shkolla fillore "Trpinja" udhëhiqet nga ideja se çdo nxënës mund t'ju ndihmojë nxënësve më të vegjël në të nxënët. Nxënësit më të vjetër me nota më të ulëta në matematikë u ndihmojnë nxënësve më të vegjël në shkollë me detyrat në matematikë. Nxënësit më të vegjël e marrin ndihmën e nevojshme, kurse nxënësit më të rritur zhvillojnë vetëbesim dhe motivim për të nxënë. A ekziston mënyrë më e mirë e të nxënët dhe përmirësimit të notave se kjo mënyrë? Kështu largohen etiketat që jepen shpesh – se dikush nuk është i mirë në lëndë të caktuar – që shpesh i de motivon nxënësit në avancimin dhe rritjen e mëtejshme.



*Nxënësve me SES të ulë u nevojitet ndihmë plotësuese sepse varfëria ndikon në suksesin e tyre shkollor. Gjithashtu është me rëndësi t'u jepet mundësi nxënësve të cilëve u nevojitet ndihma njëkohësisht edhe të ofrojnë ndihmë. Ata mund t'ju ndihmojnë nxënësve nga klasat më të ulëta në të nxënët, mund të mendojnë mundësi të ndryshme për ata për punë vullnetare në shkollë ose bashkësinë vendore. Kjo është e rëndësishme për vetëbesimin e tyre, aftësitë ripërtëritëse, angazhimin në shkollë dhe aspiratat arsimore, si edhe për përfitime të tjera të theksuara nga AJM-të.*

## ▶ Të vegjël, e megjithatë të mëdhenj – të mëdhenj, e megjithatë të vegjël

Shkolla zhvilloi edhe një projekt tjetër i quajtur *Të vegjël, e megjithatë të mëdhenj – të mëdhenj, e megjithatë të vegjël*. Si sqaruan vetë, nxënësit ishin "të vegjlit" kurse anëtarët më të rritur të bashkësisë vendore ishin "të mëdhenjtë". Qëllimi i kësaj punëtorie ishte shoqërimi joformal me shkëmbim të shkathtësive dhe njohurive. Më të rriturit rikujtoheshin në ditët e tyre të kaluara në shkollë dhe shkëmbenin anekdota të ndryshme me nxënësit. Njëkohësisht u treguan më të vegjëlve si të qepin dheu prezantuan lojëra nga rinia e tyre. Nga ana tjetër nxënësit u treguan më të rriturve si të përdorin telefona mobil, tabletë dhe kompjuter. Komentet nga mësimdhënësit tregojnë sa ky shoqërim i gëzoi edhe nxënësit edhe më të rriturit: *Nuk shihej kush është "i madh", e kush është "i vogël" për shkak të buzëqeshjes së lumtur në fytyrat e mysafirëve.*

*Nxënësit zhvillojnë njohuri, shkathtësi dhe qëndrime të ndërlidhura në arsimin qytetar, zhvillim personal dhe social kur mësojnë për qytetërim aktiv nëpërmjet pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë në aksionet vullnetare lokale. Njëkohësisht zhvillojnë reagime më të mira ndër personale, ndjenjë të përkatësisë ndaj shkollës dhe besim në mundësinë për fillimin e ndryshimeve në jetën e tyre dhe në jetën e njerëzve të tjerë (Pavloviç e tjerë, 2017).*

*"Nxënësit të cilët etiketohen si "problematik" ishin më aktiv dhe më të përgjegjshëm në aktivitetet vullnetare. Kishin mundësi t'i tregojnë potencialet dhe virtytet e tyre jashtë nga procesi arsimor"*

Mësimdhënësi, Projekt Fillo ndryshimin, 2013-2015

## > Shkollë e mesme Pullë <

Në këtë shkollë kroate, nëpërmjet aktivitetit të projektit Fillo ndryshimin, nxënësit deklaruan se kishin për qëllim ta ngenë vetëdijen për dallimet socio – ekonomike mes nxënësve dhe ta vërejnë nevojën për respekt të ndërsjellë, pa marrë parasysh statusin material të dikujt.

### ▶ Shoh njeri

Shkolla e realizoi projekt të quajtur “Shoh njeri” me qëllim orientimin dhe forcimin e mësimdhënësve që të bisedojnë me nxënësit e tyre për dallimet ekonomike dhe t’i zgjidhin problemet që dalin nga këto. Ekipi projektues deklaroi, se ndërmjet tjerash, dëshironin ta ngenë vetëdijen e nxënësve për paragjykimet dhe stereotipat të cilat dalin nga dallimet e qarta dhe ta forcojnë ndjenjën e përgjegjësisë për sjelljen personale. Qëllimi ishte t’u ofrohen nxënësve dhe mësimdhënësve njohuri për ekzistimin, shkaqet dhe pasojat e varfërisë nëpër botë dhe në Kroaci, por edhe në bashkësinë e tyre vendore. Nxënësit që ndoqën orë zgjedhore në Arsim qytetar dhe Klub debati morën pjesë në projektin gjatë tërë semestrit të dytë dhe ia përkushtuan temës varfëria.

Nxënësit në grupe realizuan hulumtime për konceptin varfëri dhe aspektet e ndryshme të saj. Pastaj, secili grup i nxënësve miratoi nga një temë nga temat e shumta të cilat i përcaktuan: shkaqet dhe shpërndarja e varfërisë, migrimi ekonomik, lëvizshmëria sociale, varfëria në Kroaci dhe në BE, lidhja mes varfërisë dhe arsimit, rritjes, shëndetit, dhunës etj. Ata punuan në temën e zgjedhur dhe pastaj i prezantuan gjetjet e tyre para nxënësve tjerë. Nxënësit e vitit të tretë i dëgjuan prezantimet e shokëve të klasës në orët e sociologjisë, kurse ata të vitit të katërt në orët e politikës dhe ekonomisë. Reagimet e tyre ishin të shkëlqyeshme sepse prezantimet u mundësuan nxënësve të përfshihen dhe t’i shkëmbejnë përvojat e tyre një ekipi të caktuar.

Qëllimi i tyre është të vazhdohet të bisedohet për temat të cilat nxënësit mendojnë se janë të rëndësishme e të cilët nuk punohen mjaftueshëm për shkak të kurrikulës së ngarkuar.

*Nxitni nxënësit që të mendojnë në mënyrë pozitive për varfërinë dhe ndihmoni të bëhen ekspert në këtë temë. Përveç rezultateve pozitive nga shfrytëzimi i nxënësve si ekspert, ata bëhen të vetëdijshëm për qëndrimet e ndryshme në raport me varfërinë, siç është besimi në kulturën e varfërisë ose teorisë së deficitit. Këto aktivitete mund t’ju ndihmojnë nxënësve me SES të ulët, shokët e tyre të klasës dhe mësimdhënësit më mirë t’i kuptojnë bazat e varfërisë e cila zakonisht mendohet vetëm si mungesë e burimeve financiare për të cilët akuzohen personat me SES të ulët. Kështu, është me rëndësi të pranohet roli personal dhe përgjegjësia në ballafaqimin me pabarazinë socio – ekonomike në jetën e përditshme dhe në jetën shkollore.*

## > Shkolla e mesme “Vitorio Emanuele II” <

Aktivitetet projektuese në këtë shkollë italiane filluan me analizë të problemit të cilën e përgatitën nxënësit dhe mësimdhënësit e që ishte në lidhje me rrethimin e tyre personal. Në fund, të gjithë erdhën deri te probleme të ngjashme pa marrë parasysh moshën e tyre ose klasën në të cilën mësojnë nxënësit. U përcaktuan problemet vijuese: mungesë e komunikimit mes nxënësve të klasave të ndryshme dhe mes nxënësve dhe të punësuarve.

U zhvillua ideja të kërkohet vend ku do të mund të takoheshin dhe e cila mund të sigurojë hapësirë ku do të mundën të komunikojnë, të shoqërohen dhe së bashku ta kalojnë kohën e lirë. Ishte shumë me rëndësi që për hapësirën të kujdesen vetë nxënësit, që mundësoi të mendojnë në mënyrë kreative si më së miri ta shfrytëzojnë hapësirën dhe u dha ndjenjë të përgjegjësisë.

Nxënësit e vitit të dytë dëshironin të përqendroheshin në stimulimin e dialogut. Gjetën vend në hapësirën e përbashkët, ashtu që ndanë një pjesë të murit që nxënësit të mund të shkruajnë tema për të cilat janë të interesuar të diskutojnë. Nxënësit e dekoruan murin me vizatime dhe postere dhe bënë “murin e komunikimit”.

Nxënësit e vitit të parë ishin të përgjegjshëm për pajisjen e hapësirës së përbashkët me mobilie që siguroi hapësirë për aktivitete të llojit të seminarit, punëtorive, tutori për shokët e klasës, projeksione të filmave, sesione të leximit.

Ky projekt e përforcoi komunikimin mes nxënësve të klasave të ndryshme dhe u dha mundësi t’i shkëmbejnë pasionet dhe interesat e tyre, me këtë projekt synonte ta bëjë shkollën vend të këndshëm ku të gjithë janë të mirë se ardhur dhe mundën në mënyrë aktive të kontribuojnë. Njëkohësisht, nxënësve u mundësoi ta shkëmbejnë mendimin e tyre me udhëheqësin e shkollës.

*“Kjo ishte përvojë interesante sepse punuam së bashku dhe biseduam për çështje të cilat na brengosin, siç janë diskriminimi. Ndjehem sikurse mësoj çka do të thotë të jesh pjesë e një bashkësie dhe të bisedosh me njerëzit”. Koment i një nxënësi.*

*“I përmirësuam raportet me mësimdhënësin, tani mendojmë se kemi kuptim të ndërsjellë më të mirë dhe kemi hapësirë të tregojmë çka mendojmë se ata e kanë të rëndësishme”. Koment i një nxënësi*







*Është me rëndësi të dëgjohet zëri i nxënësit – dëshirat e tyre për jetën dhe rregullat në shkollë. Ndjenja se mund të ndikojnë në jetën shkollë dhe përmirëson mirëqenien e tyre.*

*Aktivitetet e tilla janë veçanërisht të rëndësishme për nxënësit me SES të ulët, sepse siç pohon Sharp (2014), këto aktivitete shpijnë drejt ndjenjës të nxënësit se janë të aftë të ndryshojnë diçka të vetja ose të rrethina e tij për një qëllim të vlefshëm, që mund të forcojë aftësitë ripërtëritëse dhe përshtatjes ndaj sfidave të jetës.*

*Studime të shumta empirike (Brofi&God, 1996; Solom&Kendal, 1979) tregojnë se raportet me mësimdhënësit që karakterizohen me ngrohtësi dhe mbështetje veçanërisht janë të dobishme dhe motivuese për nxënësit me SES të ulët.*

## ▶ 2.2 PUNËTORI PËR NXËNËS, MËSIMDHËNËS DHE PRINDËR

Punëtoritë e përshkruan në këtë pjesë mund të përdoren në punën me nxënësit, mësimdhënësit dhe prindërit.

Këto aktivitete mund të ndihmojnë për kuptim më të mirë të zhvillimit personal dhe social si dhe rëndësinë e rolit personal në shkollë dhe në bashkësinë vendore dhe përmbajnë tema siç janë vet-reflektimi, vet-perceptimi pozitiv, njohje e talenteve personale, përkufizim i qëllimeve personale, nxitje e aspiratave, empatija, të qenit të bashkuar...

Me futjen e këtyre temave zhvillohen njohuri, shkathtësi dhe qëndrime me të cilat dallohen fëmijët dhe të rinjtë si pjesëmarrës aktiv në bashkësi, nxitet roli dhe përgjegjësia e të gjithë nxënësve në formimin e mjedisit që i rrethon dhe sjellja e vendimeve të cilat e formojnë botën e tyre, ata aftësohen më mirë të kuptojnë vetveten, të shprehin dhe ta shprehin identitetin personal, si dhe të lidhen me të tjerët.

Kur i përfshini të gjithë nxënësit në këto punëtori u ndihmoni atyre që kanë SES të ulët që të zhvillojnë kompetencat personale dhe sociale pa i përjashtuar si nxënës të cilëve u duhet mbështetje plotësuese në këtë fushë, gjatë kësaj duke krijuar mundësi që nxënësit më mirë të njihen dhe mundësi që mësimdhënësit të zhvillojnë raporte më të mira me nxënësit. Në këtë mënyrë, ndihmoni të krijohet ndjenja e përkatësisë ndaj grupit por edhe klimë shkollë pozitive. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për nxënësit me SES të ulët të cilët shpesh janë të ekspozuar në dhunë nga moshatarët dhe të cilët më rrallë hynë në ndërveprim pozitiv me nxënësit dhe mësimdhënësit për shkak të paragjytimeve.

Nëse zbatohen me mësimdhënësit ose prindërit, këto punëtori mund t'u ndihmojnë të rriturve më mirë t'i kuptojnë dhe të mendojnë për temat e përmendura dhe në këtë mënyrë më mirë t'u ndihmojnë nxënësve. Me forcim të bashkëpunimit dhe mbështetjes mes prindërve dhe mësimdhënësve forcohen gjasat nxënësit të arrijnë zhvillim të forcuar socio-emocional dhe njohës, e me këtë edhe sukses më të lartë akademik.

Disa punëtori pikësëpari u janë dedikuar nxënësve e disa prindërve, në secilën punëtori është e shënuar moshë dhe grupi të cilës i dedikohet. Megjithatë, ekspertët të cilët i realizojnë punëtoritë e veçanta duhet vet të vendosin cilat punëtori janë më të përshtatshme për grupet e tyre.

Disa nga temat që trajtohet u nevojiten kohë shtesë për zbatim kualitativ. Për shkak të specifikës dhe përfshirjes së tyre ndoshta u nevojitet përgatitje plotësuese, e ata të cilët do t'i realizojnë këto aktivitete u rekomandohet që t'i studiojnë në mënyrë plotësuese dhe thellësisht këto tema dhe të marrin pjesë në zhvillimin profesional të këtyre fushave.

Realizimi i punëtorive *Aftësi ripërtëritëse psikologjike* dhe *Përtejvijës* u rekomandohen personave me njohuri dhe përvojë paraprake në realizimin e punëtorive me përmbajtje të ngjashme.

## 1. Aktivitet: Ky jam unë

### Materiale të nevojshme:

- Fletë punë Ky jam unë
- Lapsa, ngjyra
- Fletë të bardha të zbrazëta

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (12-18)



### Përgatitje:

Klasa duhet të rregullohet për punë grupore. Ky është një aktivitet i shkëlqyeshëm nëse punoni me grup të ri të njerëzve (të përdoret si hyrje), por edhe nëse doni që anëtarët e grupit ekzistues të njohohen më mirë.



### Aktiviteti:

1. Në fillim, nxënësve duhet t'u jepen këto instruksione: Mendoni për vete dhe përshkruani veten me 10 fjalë në fletë letre.
2. Pas disa minutave, pyetni nxënësit: Çka ju kujtua në fillim?
3. Shënioni disa nga përgjigjet dhe së bashku me nxënësit gruponi ato. A folën për pamjen e tyre, karakteristika personale, nga vijnë...?
4. Sqaroni fëmijëve: Sot do ta shqyrtojmë konceptin e identitetit dhe do të fillojmë të kuptojmë si është krijuar identiteti juaj dhe nga çka përbëhet. Do të shohim a është statik ose i ndryshueshëm dhe deri në cilën masë mundemi vet t'i japim formë. Ndjenja juaj për vete do të jenë të rëndësishme së madhe në jetë dhe do të ndikojë në ndjenjat tuaja për veten dhe për personalitetin tuaj si dhe për vet-besimin dhe vet-pranimin tuaj.
5. Jepni fletën e punës Ky jam unë nxënësve, të cilët duhet të shkruajnë çka është ajo që mendojnë se është më e rëndësishme tek identiteti personal.
6. Kur do të mbarojnë, bisedoni në grup dhe kontrolloni cilat karakteristika dhe role i kanë përdorur.


### PYETJE PËR DISKUTIM:

- Çka përmendët si karakteristika kryesore (të quajtura edhe "Shtylla" të identitetit)?
- A jemi ballafaquar ndonjëherë me profil stereotip ose diskriminim për shkak të ndonjë aspekti të identitetit tuaj? Cili? Çka mendoni për njerëzit që i trajtojnë keq të tjerët për shkak të prejardhjes kulturore/përkatësisë etnike të tyre ose ndonjë aspekt tjetër të identitetit?
- Cilat janë pjesët e preferuara të identitetit tuaj?
- Cilat aspekte të identitetit personal i marrin si të tilla dhe nuk mendoni për ato?
- Sqaroni lidhjen mes rrjetet sociale dhe identitetit.



### Ide +:

- Hulumtoni kuptimin "identitete të shumta" – identitete të ndryshme në kuadër të një personaliteti të cilët ndonjëherë janë në konflikt njëri me tjetrin – dhe bisedoni për këtë me nxënësit.



**Nga çka përbëhet identiteti?**

Identiteti jonë në masë të madhe është formuar nga mënyra si ne e shohim vetveten. Kjo fotografi zhvillohet nëpër tërë jetën tonë, veçanërisht në periudhën e fëmijërisë dhe adoleshencës. Ai përbëhet nga përvoja gjegjësisht vija të karakterit dhe nga mënyra si këto gjëra ne i interpretojmë. Disa nga këto "shtylla", gjegjësisht karakteristika të identitetit, përmenden më poshtë, e sa ato janë të rëndësishme ndryshon gjatë jetës.

Mosha	Shkolla të cilën e ndjekim	Karakteristika personale
Gjinia	Çka bëjmë	Sjellje dhe vendime
Emri dhe mbiemri	Fqinjët tuaj	Hobi, interesa, stil jetësor
Pamje: karakteristika fizike (lartësia, pesha, ngjyra e flokëve dhe prerja e tyre...), çka mbajmë	Statusi financiar	Vlera dhe qëllime (çka me të vërtetë e keni të rëndësishme dhe çka synoni)
Origjina: Familja juaj, nacionaliteti, feja, gjuha	Miqësia	Konteksti historik dhe gjeografik në vendin ku jetoni
Rrjete sociale	Raporte (djalë/vajzë, partneritet)	....
	Shëndet dhe kondicion fizik...	

**2. Aktiviteti: Kolazhi im**

**Materiale të nevojshme:**

- Më shumë revista me ngjyra për kolazhin
- Gërshërë dhe ngjitëse
- Hamer/fletë të formatit të madh

**Aktivite për:**

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (10-18)

**Përgatitja:**

Do t'ju duhen gërshërë për çdo nxënës, ngjitësen dhe revistat mund t'i ndajnë. Mbani mend se në numër të madh të revistave nuk mund të gjeni grupe të ndryshme, siç janë pakicat, njerëz me SES të ulët... Shfrytëzoni këtë për bisedë me nxënësit.

**Aktiviteti:**

1. Filloni me hyrje: Çdo njeri është unik. Të gjithë jemi të ndryshëm nga të tjerët dhe të gjithë ndryshojmë me kalimin e kohës. Sot do të jemi kreativ dhe secili do të punoj poster në të cilin do ta prezantojë veten. Përdorni fletë letre, revista dhe ndani ndërmjet vete. Përdorni fotografi dhe fjalë. Emërtoni posterin tuaj. Në fund vëni nënshkrimin në pjesën e prapme. Në varësi nga mosha e nxënësve tuaj, mund t'ju tregoni shembuj nga artistët të cilët e trajtojnë çështjen e identitetit në artin e tyre (mund ta përdorni shembullin nga fleta e punës).
2. Thoni nxënësve të ndahen në çifte dhe t'ia tregojnë partnerit posterin që e kanë bërë. Ekspozoni postaret dhe jepni nxënësve kohë të mjaftueshme t'i shikojnë dhe nëse duan t'i parashtrajnë pyetje njëri tjetrit.

**+ Ide +:**

- Gjithashtu mund të filloni me pyetje hyrëse nga tri kategori të cilët do ta udhëheqin procesin e vet-prezantimit të nxënësve: çka doni të bëni, çka ju frikëson (simbole) dhe si doni të duket ardhmëria juaj.
- Ekspozoni posterët në vend të dukshëm në klasë dhe pas një kohe thoni që t'i bëjnë përsëri.
- Nxitni nxënësit të krijojnë kolazh të shkollës.
- Mund ta shfrytëzoni këtë aktivitet për njohje të ndërsjellë më të mirët prindërve me mësimdhënësit.

**ÇËSHTJE PËR DISKUTIM:**

- Si ndjeheshit kur e bënit posterin? Çka ju pëlqeu më së shumti?
- Si ndjehesh tani? A më pëlqen posterin?
- Si e bërë? A i njohje në mënyrë automatike fotografitë dhe fjalët që i ke të afërt, gjegjësisht së pari a e mendove konceptim e pastaj fillove t'i kërkosh fotografitë?
- A e kishe vështirë të gjesh fotografi që ta njohësh identitetin tënd? Çka bërë pastaj?
- A e kishe me rëndësi të shohësh çka bëjnë të tjerët që të bësh diçka të ngjashme me posterin e tyre?



► **Autor:** Greg Gossel, <http://www.greggossel.com/>

► **Burimi:** <http://gabrielaaicorbe.blogspot.hr/2008/08/greg-gossel-retro-comics-americanos.html>

**Greg Gosel** është dizajnues i lindur në vitin 1982 në Viskonsin. Jeton në Mineapolis kurse veprat e tij janë të ekspozuar në tërë SHBA-të dhe në Evropë, për shembull në San Francisko, Njujork, Los Angeles, Milano, Londër.

**Vërejtje:** \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

### 3. Aktiviteti: Elementi im

#### Materiale të nevojshme:

- Fletë pune Zbulo elementin tënd
- Fletë pune Heksagrami i Holandit

#### Активност за:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (10-18)

#### Përgatitje:

Kur do të filloni me aktivitetin keni në mend se disa nxënës ndoshta mendojnë se nuk kanë asnjë talent – ofroni mbështetje dhe sqaroni se është krejtësisht e zakonshme që në moshën e tyre ende të gjurmojnë talentin e tyre.

#### Aktiviteti:

1. Filloni me diskutim hyrës: *Sot do të flasim për talentet tuaja! A mendoni se të gjithë keni ndonjë talent?*  
*Pse? Si e zbuloni për çka jeni të mirë dhe çka ju intereson? A e keni zbuluar këtë? A ka ndonjë ndërmjet jush me interesa aktive jashtë shkollës? Na tregoni diçka për atë?*
2. Tregoni nxënësve Fletën e punës *Zbulo elementin tënd* thoni ta plotësojnë në çifte.
3. Pas diskutimit, prezantoni para nxënësit *Tipologjinë e karrierës së Holandit* (ose ndonjë koncept të ngjashëm të lidhur me talente/profesionet) dhe bisedoni për atë. Plotësoni ushtrimin “Heksagrami i Holandit”. Theksoni faktin se në shumicën e profesioneve moderne është e rëndësishme të kenë shkathtësi në më shumë fusha. Nëse doni, tregoni rrugën tuaj të karrierës gjegjësisht tregimin tuaj për atë si e keni zgjedhur profesionin tuaj ose si i keni zhvilluar shkathtësitë që i posedoni.

#### ÇËSHTJE PËR DISKUTIM:

- KA e kishit lehtë ta zbuloni elementin tuaj? A keni më shumë se një?
- Nëse do të duhej të zgjidhni mes asaj në të cilën jeni i mirë dhe atë që e doni, çka do të zgjidhni?
- Sa nga ju do të zgjidhnin profesion vetëm se do të mund të punësohen më lehtë ose se do të keni rrogë më të lartë?
- A do t'i ndiqni këshillat e prindërve ose interesat personale dhe pse?
- Cilat profesione ekzistojnë sot e për të cilat prindërit tuaj as që kanë dëgjuar?
- Ku do të mund të orientohen shkathtësitë dhe talentet tuaja?
- Si do t'i gruponi aktivitetet dhe profesionet e njerëzve?

## Fleta e punës 1: Zbulo elementin tënd!

Koncepti i "elementit" është i bazuar në librin *Element: Si zbulimi i pasionit tuaj ndryshon gjithçka* nga Ser Ken Robinson (2010).

Elementi është pika në të cilën talenti natyror përputhet me pasionin personal. Ky është vendi ku njerëzit më së shumti ndjehen mirë, të inspiruar dhe të aftë që të arrijnë nivelin më të lartë.

Shkruaj disa ide në secilën kolonë (gjëra që do, në çka je i mirë, në çka kënaqesh kur e ën dhe gjëra në të cilat ti ndihmohesh) dhe shih ku ato përputhen. Ajo që përsëritet në më shumë kolona mund të jetë elementi jot!

Dua	Jam i mirë në	Kënaqem kur	Më ndihmojnë me... Kam mundësi të...

### > Si mund t'u ndihmoni njerëzve ta gjejnë "shkëndijën" e tyre ose profesionin jetësor?

Ashtu që:

1. e njihni dhe e ndjeni "shkëndijën" e tyre;
2. do të krijoni mundësi që të provohen aktivitete të ndryshme;
3. do t'i dëgjoni me kujdes kur flasin për atë që i intereson;
4. do t'i mbështetni;
5. veproni si model dhe do t'i shkëmbeni interesat dhe "shkëndijat" tona dhe
6. do t'i përfshini këto aktivitete në kurikul.

(William Damon: *The Path to Purpose: Helping Our Children Find Their Calling in Life*. 2008)

## FLETA E PUNËS 2: Tipologjia e karrierës sipas Holandit

### Real

punojnë me vegla, prodhime, ushqime, sende mekanike, vizatime teknike, bimë, kafshë, kanë shkathtësi fizike

### Hulumtues

i kuptojnë dhe i zgjidhin problemet shkencore dhe matematikore

### Artistik

teatër, art figurativ, vallëzim, muzikë, të shkruar, punime dore

### Social

u ndihmojnë të tjerëve, mësimdhënie, përkujdesje, ofrim i informatave

### Sipërmarrës


udhëheqin, bindin të tjerët, shesin ide dhe prodhime

### Konvensional

punojnë me numra, të dhëna, organizojnë dhe rregullojnë

> Në secilën pjesë të heksagramit shkruaj shkathtësitë tuaja dhe përvojat në atë fushë:

- ▶ 1. **Reale/Realizues:** në çka je i shkathët?
- ▶ 2. **Hulumtues/Mendimtar:** çfarë probleme do të zgjedhësh?
- ▶ 3. **Artistik:** çka do të krijosh dhe si shprehesh në mënyrë kreative?
- ▶ 4. **Sociale:** kujt dhe si do t'i ndihmosh?
- ▶ 5. **Sipërmarrës:** çka fillon vet e të tjerët të ndjekin?
- ▶ 6. **Konvencionale/Organizues:** në çfarë mënyre i ke rregulluar dhe organizuar gjërat?



Merre parasysh rëndësinë e secilit nga këto aktivitete që i ka për ty dhe sa të pëlqen. Pastaj, përpiqu të zgjedhësh deri në tre fusha për të cilat mendon se janë ana jote e fortë. Cili profesion do të mundëson t'i tregosh të gjithë kualitetet tuaja?

*Heksagrami i Hollandit përdoret gjerësisht për t'iu ndihmuar njerëzve që të kuptojnë veten e tyre dhe të drejtojnë zhvillimin e karrierës së tyre. Këtë e zhvilloi psikologu amerikan Xhon L. Holand (1959).*

#### 4. Aktiviteti: Ndjeje "rrjedhën"

##### Materiale të nevojshme:

- Fleta letre A4
- Lapsa
- Ngjyra

##### Aktivite për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (10-18)

##### Përgatitje:

Hulumtoni konceptin e "rrjedhjes" (Çikzentmihajl, 1996).

Koncepti "rrjedhë" është marr nga teoria e përvojës në "rrjedhë" e Çikzentmihajli (1996). Karakterizohet me angazhim të tërësishëm me atë që në moment bëhet, humbja e ndjenjës së individit për vendin dhe kohën që del nga angazhimi i tillë. Psikologët "rrjedhën" të përshkruar në këtë mënyrë e llogarisin si të rëndësishme në mirëqenien e tërësishme.

##### Aktiviteti:

1. Thoni nxënësve cilin e keni aktivitet të preferuar, përshkruani si ndjeheshit herën e fundit kur e realizuat. Mund të jetë çdo gjë në të cilën ju ishit tërësisht i përkushtuar derisa e realizoni, dhe në rast ideal, duhet të jetë diçka që ju ndihmon të rriteni si person. Përpiquni t'i përshkruani ndjenjat të cilat ky aktivitet i nxit te ju dhe nëse është e mundshme, tregoni diçka që është e lidhur me atë (send të cilin e keni punuar ose shkathtësi që e posedoni) dhe nxitni që të parashtrojnë pyetje.
2. Nxitni nxënësit të mendojnë cili aktivitet i tërheq dhe në çka kënaqen kur e bëjnë. Sqaroni se ky aktivitet duhet me të vërtetë të jetë diçka që e bëjmë në mënyrë aktive dhe se nuk jemi pasiv si për shembull gjatë shikimit të televizionit, gjatë fjetjes, të ngrënit ose diçka të ngjashme). Jepni kohë disa minuta. Nëse duan mund t'i shënojnë përgjigjet e tyre. Nxitni nxënësit t'i shkëmbejnë konkluzionet e tyre me të tjerët.  
(Psikologët këto përvoja i quajnë "rrjedhë" dhe i llogarisin si shumë të rëndësishme për mirëqenien tonë psikologjike dhe për lumturinë).
3. Pastaj jepni nxënësve fletë letre – duhet të vizatojnë si ndjehen deri sa ishin të angazhuar me aktivitetin. Motivoni: Kujtohuni ku ishim, çka bënim, me kë ishim dhe çka ishte më interesante. Sqaroni nxënësve se shkathtësitë e tyre vizatuese nuk janë kyçe, më e rëndësishme është çka vizatimi paraqet për ata.
4. Nxënësit duhet t'ua tregojnë aktivitetet e tyre të tjerëve në grupe më të vogla.

##### ÇËSHTJA PËR DISKUTIM:

- A ka ndonjë aktivitet i cili është i përbashkët, në të cilin më shumë nga ju kënaqeni kur e realizoni?
- A e ndjetë "rrjedhën"? Çka mendoni? Pse këto përvoja janë të rëndësishme?
- Çka ndodh nëse ndonjë ndjen se nuk ka asgjë të ngjashme në jetën e tij? Cilave aktivitete mund t'ju përkushtohen dhe cilat janë pasojat?
- A ndjeheni ndonjëherë kështu në shkollë – sikur tërësisht janë të angazhuar me atë që e bëjnë?
- Si duhet të duket një klasë me "rrjedhë" më të fortë, sipas jush?

## 5. Aktiviteti: Nga inspirimi deri tek aksioni

### Materiale të nevojshme:

- Fletë letre Intervistë për inspirim dhe Dëshirat dhe qëllimet e mia
- Lapsa

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (14-18)



### Aktiviteti:

#### Pjesa 1: Çasti

Ndani nxënësit në çifte dhe thoni të rikujtohen në një çast të shkëlqyeshëm të cilin e kanë përjetuar në vitin e kaluar. Mund të jetë diçka çka kanë arritur, me të cilën krenohen, ose në çka kanë punuar. Gjithashtu mund të jetë diçka që i ka bërë të lumtur dhe të cilën e kanë të rëndësishme. Detyra e tyre është që t'ua përshkruajnë atë çast shokëve të klasës sa është e mundshme më hollësisht, kurse partneri i tyre duhet të dëgjoj me vëmendje. Disa nga nxënësit pastaj mund të rrëfejnë si kanë punuar së bashku dhe çka kanë mësuar.

Pastaj sqaroni nxënësve se do të punoni në planifikimin personal dhe në vendosjen dhe realizimin e qëllimeve, që paraqesin shkathtësi të rëndësishme jetësore. Pyetni çka mendojnë, pse e punoni aktivitetin Çasti. Theksoni se aktiviteti mund të zbulojë shumë për gjërat të cilat i çmojmë shumë dhe janë të rëndësishme për ne dhe se kjo paraqet bazë për vendosjen e qëllimeve të rëndësishme jetësore, sepse qëllimet i vendosim për vete e jo për të tjerët.

#### Pjesa 2: Intervistë për inspirim

Vazhdoni të punoni në çifte dhe jepni nxënësve detyrë të re. Secili nxënës do t'i parashtror vetes një qëllim, kurse një nxënës tjetër do ta përdor metodën e intervistës që t'i ndihmojë që në hollësi të planifikojë. Nëse nxënësi nuk mund të vendos për qëllimin e tij, partneri i tij/i saj do të parashtror pyetje që të zbulojë cili është fokusi dhe për cilën fushë nxënësi do të donte të përcaktohej që të punojë. Mund të jetë diçka që nxënësi e do ose për të cilën kujdeset, ose diçka për të cilën mendon se i mungon dhe do të donte më shumë ose më mirë ta bëjë. Është me rëndësi që nxënësit të motivohen dhe që qëllimi i tyre të jetë i rëndësishëm për ata. Pastaj, çdo çift vazhdon me intervistë, duke i përdorur katër pyetjet që janë në faqen vijuese.

#### ÇËSHTJET PËR DISKUTIM:

- Si ju pëlqeu puna në çifte?
- Si ju pëlqeu parashtrimi i pyetjeve, e si përgjigjja dhe të folurit për veten?
- Çka kuptuat dhe mësuar?
- A mendoni se është e rëndësishme të planifikohet ose duhet vetëm t'i lëni gjërat të ndodhin sipas rrugës natyrore? Kur është e pëlqyeshme diçka të bëjmë në një mënyrë e kur në mënyrë tjetër?
- Çka mund të bëni nëse në diçka nuk jeni të mirë dhe keni vështirësi ta realizoni qëllimin tuaj?



#### Ide +:

- Mënyrë tjetër që ta filloni këtë punëtori (në varësi nga koha që keni në dispozicion) është aktiviteti Lumi i të nxënësve. Ky aktivitet kreativ në të cilën nxënësit vizatojnë dhe ngjyrosin lum i cili e paraqet jetën e tyre nga lindja deri në ditët e sotme në një fletë të madhe letre. Pastaj nxënësit përdorin simbole, ilustrime ose fjalë që t'i shënojnë njohuritë ose shkathtësitë e rëndësishme që i kanë fituar, çastet kyçe dhe njerëzit nga të cilët më së shumti kanë mësuar.



## FLETA E PUNËS 1 Nga inspirimi deri tek aksioni

### INTERVISTË PËR INSPIRIM

Punoni në çifte. Zbuloni më së shumti që mundeni për partnerin dhe parashtroni pyetje që t'i ndihmoni ta përkufizojë qëllimin dhe planin e tij. Ndiqni këto katër pjesë:

#### QËLLIMI

Në cilën qëllim do që të punosh tani?

(Nëse partneri jot ka vështirësi në përkufizimin e qëllimit, parashtroni një nga pyetjet vijuese: Në çka më së shumti kënaqesh? Çka të gëzon dhe çka është interesant për t? A ka diçka në të cilën tërësisht thellohesh? Kur ndjehesh se me të vërtet je atje ku duhet tujesh? Në çka je më i suksesshëm/e suksesshëm? Çka mendojnë të tjerët cilën e ka anën më të fortë? Çka mendon se e ke qëllim për çastin?)

#### VIZION

Mendo ardhmërinë tënde ideale ku tërësisht i ke realizuar qëllimet e tua! Si duket? Çka ën, si dukesh, kush është i pranishëm? Çka është e ardhshme?

#### ARRITJE

Tani bëj plan – çka është më me rëndësi që të mund të realizosh qëllimin tënd? Çka duhet të mësosh, të bësh dhe të ushtrosh që ta realizosh? Cilat shkathtësi duhet t'i zhvillosh? Cila është rruga jote dhe si me të vërtet shihesh derisa e realizon qëllimin tënd?

#### HAPAT E PARA

E tani të fillojmë! Mendoni për hapat e para që duhet t'i ndërmarrësh. Çka do të bësh në fillim? Kush mund të të ndihmojë? Me kë duhet të flasësh? Çka pas kësaj? Sa kohë do të duhet? Çka do të mund të ishte sfidë tani, e çka më vonë? Si do ta zgjedhësh këtë?

**Pastaj ndërroni rolet!**

Të pyeturit pozitiv (Appreciative Inquiry - AI) për herë të parë u fut në vitet 1980 nga Dajvid Koperajder (David Cooperrider) dhe Suresh Srivastva (Suresh Srivastva), profesor në fakultetin e menaxhimit Weatherhead në kuadër të Universitetit Case Western Reserve. Ky model synon t'i përfshijë palët e interesuara për ndryshime të cilat vet i përcaktojnë. Autorët duan të theksojnë se qasja e zgjidhjes së problemeve nuk është çdoherë më e mira dhe se nevojiten mënyra pozitive për hulumtimin e ideve dhe për zhvillim.

## FLETA E PUNËS 2 Dëshirat dhe qëllimet e mia

### DËSHIRAT DHE QËLLIMET E MIA

Mendo për veten dhe për jetën tënde në pesë vitet e ardhshme. Shqyrto pjesët e posaçme të jetës tënde dhe përkufizo disa qëllime për secilën pjesë! Mund të shkruash në fleta ose në fletoren tënde sekrete. Lirisht shto ende fleta (ide: Çka dua të provoj, të shoh; Si dhe ku dua të jetoj...)

*instruksione për vizatimin e botës me gjashtë fleta, në secilën fletë është e shkruar kjo*

**1. ARDHMËRIA IME** – çka dua të arrij

**2. UNË** – identiteti im; çfarë njeriu dua të bëhem

**3. JAM I MIRË NË...** – çka dua të mësoj dhe të përmirësoj

**4. PUNA VULLNETARE** – si dua të kontribuoj për bashkësinë time

**5. PAMJA DHE SHËNDETI** – çka mund të bëj për trupin dhe pamjen time

**6. RAPORTE** – çfarë njeriu dua të bëhem



Vërejtje: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

## 6. Aktiviteti: Kutia e lumturisë

### Materiale të nevojshme:

- Kuti
- Lapsa, ngjyra/flloMASTER/pastel
- Fletë e punës

### Aktivite për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (8-18)



### Përgatitje:

Duhet të përgatisni kuti me etiketën Lumturi – hyni me atë në klasë dhe habisni nxënësit.



### Aktiviteti:

1. Tregoni nxënësve kutinë dhe thoni se brenda kutisë gjendet lumturia. Nëse keni nxënës më të vegjël pyetni: Çka është lumturia? Si duket lumturia? Cila është ngjyra e lumturisë? Sa është e madhe lumturia? Përshtatni pyetjet nëse keni nxënës më të rritur.
2. Thoni nxënësve të mendojnë çka do të bënin me kutinë e lumturisë nëse do ta kishin marrë si dhuratë (me kë do ta ndanin, ku do ta çonin, ku do ta rruanin, kujt do t'ia kishin treguar etj.) Mund t'i shkruajnë ose t'i vizatojnë idetë e tyre në fletë letre. Nëse nxënësit janë shumë të vegjël, aktivitetin mund ta bëni vetëm gojarisht.
3. Kërkoni nga nxënësit t'ua lexojnë përgjigjet. Në fund mund t'i shpërbleni të gjithë nxënësit me duartrokitje.
4. Pyetni nxënësit: Nëse do të mundeshit të bëni kutinë e lumturisë, çka do të vendosnit brenda? Nxënësit le të vizatojnë versionin e tyre të KUTISË SË LUMTURISË.

### ÇËSHTJE PËR DISKUTIM (për nxënës më të vegjël):

- Kur jeni të pikëlluar, çka ju kthen disponimin – përqaftimi ose bonbonia?
- Çka më së shumti do të donit të keni – shumë lodra ose shumë miq?
- Kur keni qenë më i lumtur?



### Ide +:

- Bëni libër nga përgjigjet e mbledhura dhe ekspozoni.
- Me nxënësit më të vjetër mund ta shihni dhe ta komentoni videon Çka paraqet jetë e mirë? Këshilla nga studimi më i gjatë për lumturinë
- ([https://www.ted.com/talks/robert\\_waldinger\\_what\\_makes\\_a\\_good\\_life\\_lessons\\_from\\_the\\_longest\\_study\\_on\\_happiness/transcript?language=hr#t-4074](https://www.ted.com/talks/robert_waldinger_what_makes_a_good_life_lessons_from_the_longest_study_on_happiness/transcript?language=hr#t-4074))
- Gjeni informatë për studimin për lumturinë dhe mirëqenien në vendin tuaj dhe në botë.
- Për ditëlindje, dhuroni nxënësve kutinë e lumturisë që është krijuar nga shokët e klasës.



## 7. Aktiviteti: Unë në pasqyrë

### Materiale të nevojshme:

- Fletë e madhe e letrës
- Lapsa, ngjyra/flomaster/pastel

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (8-18)

### Përgatitje:

Keni parasysh se nxënësit nuk duhet të mendojnë për ndryshime të mëdha. Sqaroni se hapat e vogla dhe ndryshime do të thonë ndryshime kah më mirë në jetën personale ose në jetën e njerëzve tjerë.

### Aktiviteti:

1. Në fillim të orës pyetni nxënësit “A mund ta ndryshojmë botën?”
2. Pastaj ndani në grupe nga pesë (nxënësit gjithashtu mund të punojnë në mënyrë të pavarur). Secilit grup i duhet fletë e madhe e letrës ku së pari do të vizatojnë pasqyre e pastaj në atë pasqyrimin e tyre në situatë kur diçka ndryshojnë në rrethimin e tyre dhe në botë. Duhet të përgatisin prezantim për vete në pasqyrë si shembull i mirë për njerëzit tjerë. Mund t’i ekspozoni punimet e tyre në vend të dukshëm në klasë.
3. Kur të gjithë nxënësit do ta mbarojnë prezantimin e tyre, mund përsëri të fillojnë të mendojnë për planin ose hapin e parë si refleksionin në pasqyrën do ta shndërrojnë në realitet dhe ashtu do t’i nxisin të tjerët të fillojnë me ndryshime.

### + Ide +:

- Në vend me anë të vizatimit, nxënësit mund të shprehen nëpërmjet video incizimit, fotografisë, këngës së re të cilën mund ta interpretojnë si rap këngë...
- Njoftoni nxënësit me citatin e Mahatma Gandit: “Bëhuni ndryshimi të cilin doni ta shihni në botë”. Çka do të thotë ky citat? Si mund ta lidhin me aktivitetin në të cilin marrin pjesë gjatë orës?
- Njoftoni nxënësit për punën vullnetare si mënyrë për fillimin me ndryshime pozitive në jetën personale ose në jetën e njerëzve tjerë.
- Zbatoni këtë aktivitet në mbledhjet e këshillit të shkollës, kur mbledheni dhe bëni plane.

## 8. Aktiviteti: Recetë për shkollë të lumtur

### Materiale të nevojshme:

- Fletë të mëdha të letrës për ekspozimin e recetës për shkollë të lumtur
- Lapsa, ngjyra/flomaster/pastelu
- Fletë e punës Shkollë e lumtur dhe Recetë për shkollë të lumtur

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Students (8-18)

### Përgatitje:

Pyetni për projektin shkollë e lumtur në doracakun Filloni ndryshimin.<sup>2</sup>

### Aktiviteti:

1. Thoni nxënësve se tema është lumturia, veçanërisht lumturia në shkollë. Pyetni pse lumturia është e rëndësishme në jetë, a dinë ndonjë recetë ose formulë për lumturinë dhe si ata do ta kishin përkufizuar. Shënoni idetë e tyre dhe së bashku komentoni, e pastaj futni në modelin teorik të lumturisë dhe pyetni çka mendojnë për atë. Flisni për atë pse është e rëndësishme lumturia në shkollë dhe çka ju ndodh njerëzve të cilët nuk janë të lumtur, si sillen dhe cilat janë pasojat. Pyetni çka mendojnë se është dallimi mes shkollës së lumtur dhe shkollës së palumtur dhe shënoni idetë e tyre.
2. Pastaj ndani nxënësit në grupe më të vogla, shpërndani fletë të mëdha të letrës dhe marker/flomaster dhe propozoni secilit grup të vizatojnë ose të shkruajnë recetën e tyre për shkollë të lumtur. Pastaj mund të flasni për poster e tyre.
3. Pas punëtorisë, nëse doni, mund t’i ekspozoni postaret në vend të dukshëm në shkollë që mësimdhënësit dhe nxënësit tjerë të mund t’i shohin.

### ÇËSHITJE PËR DISKUTIM:

- Çka mendoni, shkolla jonë a është e lumtur apo e palumtur dhe pse? Çka mund të përmirësohet?
- Kush e përcakton një shkollë a është e lumtur ose e palumtur? A mund të ndikoni me diçka në lumturinë e shkollës suaj?

### + Ide +:

- Kur do të krijoni modelin tuaj të shkollës së lumtur, tregoni modelin e UNESCO-së. A dini se ekziston model, gjegjësisht lloj “i recetës” për shkollë të lumtur?
- Organizoni këtë aktivitet për nxënës, prindër dhe mësimdhënës – çdo grup përgatit recetë dhe në fund përpikuni të gjeni recetë të përbashkët.

<sup>2</sup> <https://startthechange.net/library/>

Sipas modelit të UNESCO-së, kriteret për shkollë të lumtur janë:	Ekziston "recetë" për shkollë pa lumtur:
<ol style="list-style-type: none"> <li>1. miqësia dhe raportet në bashkësinë e shkollës;</li> <li>2. kushtet e punës dhe mirëqenia e mësimitdhënësve;</li> <li>3. liria, kreativiteti dhe angazhimi i nxënësve;</li> <li>4. puna ekipore dhe projekte bashkëpunuese, për shembull sport etj.</li> <li>5. qëndrime pozitive dhetribute të mësimitdhënësve.</li> </ol>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. dhuna ndërmjet shokëve të klasës;</li> <li>2. mbingarkim dhe stres te nxënësit;</li> <li>3. atmosferë dhe raporte të këqija në shkollë;</li> <li>4. kushte të vështira të punës për mësimitdhënësit dhe metodologjia;</li> <li>5. mësimitdhënës me qëndrime negative ndaj shkollës dhe nxënësve.</li> </ol>

### FLETA E PUNËS 1 Shkollë e lumtur

SHKOLLË E LUMTUR ËSHTË	SHKOLLË E PALUMTUR ËSHTË

### FLETA E PUNËS 2

PËRBËRËSIT	METODA

**Teoria e lumturisë** - sipas teorive bashkëkohore të lumturisë, në kuptim psikologjik, lumturia përbëhet nga plotësimi i nevojave të cilat të gjithë njerëzit i kanë:

- 1) dashuri dhe përkatësi,
- 2) aftësi dhe vet respektim dhe
- 3) pavarësi mbështetje vet në vete.

Por metoda për përmbushjen e këtyre nevojave mund të ndryshojë nga një njeri në tjetrin.

**Vërejtje:** \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

## 9. Aktiviteti: Nga nevoja deri te ide të projekteve

### Materiale të nevojshme:

- Fletë e punës
- Fletë A3 dhe A4
- Fllomaster, lapsa, ngjyra

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (12-18)

### Përgatitje:

Kjo punëtori ka për qëllim t'ju ndihmojë nxënësve t'i njohin nevojat për aktivitete ose projekte ku do të marrin pjesë në mënyrë vullnetare në shkollë ose në bashkësinë vendore. Në këtë mënyrë, nxënësit e marrin veten për pikë nisëse dhe qëndrimi i tyre për shkollën dhe bashkësinë vendore është me rëndësi. Nëpërmjet bisedës për problemet e perceptuara, nxënësit nxiten të jenë aktiv dhe të gjejnë zgjidhje. Ndjenja e tyre e pronësisë mbi idenë do të përmirësojë tërë projektin dhe do të sigurojë përfshirjen e tërësishme. Nxënësit duhet të ndahen në grupe dhe të udhëhiqen nëpër hapat vijuese.

### Aktiviteti:

**Hapi 1.** Të gjithë grupet marrin fletë punuese dhe detyrë të bisedojnë për atë cilat probleme i kanë vërejtur në shkollën e tyre dhe çka do të donin të ndryshonin. Përgjigjet duhet të shënohen në forma të ndryshme gjeometrike rreth "SHKOLLËS". Detyra vijuese për grupet e ta bëjnë hartën e karakteristikave të bashkësisë vendore në të cilën gjendet shkolla (emërtimet të institucioneve, organizatave, qendrave, parqeve, shesheve fqinje etj.) dhe të diskutojnë kujt në bashkësinë vendore do t'ju duheshe ndihma e tyre dhe me kë do të mund të bashkëpunonin.

**Hapi 2.** A4 fleta afër emrit të shkollës ngjitet në mur ose tabelë me A4 fletë të tjera përreth saj, në të cilat grupet janë të obliguar t'i shënojnë problemet e përcaktuara në shkollë. Njëkohësisht, nxënësit duhet t'i shënojnë emërtimet e institucioneve, organizatave, shesheve etj, që janë në afërsi të shkollës. Tërë procesi realizohet nëpërmjet bisedimit – pyetni nxënësit për përgjigjet të cilat i kanë shënuar. Përpikuni të përfshini sa është e mundur më shumë nxënës.

**Hapi 3.** Kërkoni nga nxënësit të shikojnë çka gjendet në mur dhe të mendojnë në cilat pyetje do të donin të punojnë nëpërmjet projektit të tyre vullnetar dhe pse. Gjatë diskutimit është me rëndësi që tërësisht të respektohen të gjithë deklaratat, ndjenjat dhe qëndrimet. Së bashku me grupin, shënoni idetë (temat, shfrytëzuesit, problemet) të cilat për momentin duken më të rëndësishme për zhvillimin e ideve të projektit.


**Hapi 4.** Pastaj nxënësit grupohen sipas interesave në ide të ndryshme të projekteve dhe secili grup prezanton idenë e tyre ashtu që u përgjigjen pyetjeve vijuese: Cili është përfitimi juaj personal nga ky projekt? A është i interesuar i tërë grupi ta realizojë këtë projekt? Cilat resurse i keni? Çka ju duhet? Nxënësit duhet të mendojnë për potencialet që i posedojnë (cilat janë talentet, shkathtësitë e tyre, kë mund ta përfshijnë etj.).

**Hapi 5.** Me mbështetje të mësimdhënësit, grupet organizojnë prezantime të ideve të tyre para ndonjë nga trupat e shkollës (për shembull para këshillit të nxënësve) dhe më tej e planifikojnë implementimin. Me rëndësi është që mësimdhënësi t'i shënojë idetë e projekteve dhe t'i mbështesë gjatë të gjitha hapave.

*Nuk është lehtë të vendoset për ide për projekt. Ndonjëherë nevojiten më shumë punëtori dhe përpilim të më shumë ideve për projekte që të mund të zgjidhet njëra. Zhvillimi, planifikimi dhe realizimi i idesë së projektit mund të zgjat një vit të tërë shkollor.*

### FLETË E PUNËS Nga nevoja deri te ide të projekteve

Bëje hartën e bashkësisë vendore në të cilën gjendet shkolla tënde. Së pari mendo cilat probleme i vëren në shkollë (ndërtesa dhe hapësirat shkollore, raportet nxënës-mësimdhënës, konfliktet mes nxënësve, etj.). Pastaj mendo cilat institucione dhe organizata gjenden në afërsi, a ka partner potencial dhe vende të cilat mund të jenë interesante për fëmijët dhe të rinjtë.



**Vërejtje:** \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## 10. Aktiviteti: Përtej vijës<sup>3</sup>

### Materiale të nevojshme:

- Hapësirë e gjerë e hapur, p.sh. klasë në të cilën të gjitha bankat dhe karriget janë vendosur afër mureve, mundet edhe në sallë ose oborr të shkollës
- Karrige të vendosura në formë rrethi për informatën kthyesë
- Shiriti trashë ngjites për shënimin e vijës fillestare për pjesëmarrësit
- Sipas dëshirës: shirit i trashë ngjites ose material tjetër që të vizatohen vijat të cilat shënojnë ku të lëvizet para ose prapa

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës



### Preparation:

Shumë njerëz të cilët kanë privilegje të caktuara asnjëherë nuk i vërejnë, sepse ata janë aq të ndërfutura në rrjedhat kryesore sa që ata që i posedojnë nuk mund t'i shohin. Për prindërit/të rriturit kuptimi dhe pranimi i privilegjeve është kyçe që të kuptojnë pse disa fëmijë nuk arrijnë rezultate aq të mira si fëmijët tjerë edhe përkaj mundësive të njëjta që u janë dhënë. Kapaciteti i prindërve që në mënyrë objektive të mendojnë për ndërveprimet e tyre me botën është e rëndësishme së madhe. Ky ushtrim do t'ju mundësojë pjesëmarrësve të kuptojnë se një privilegj nuk e kompenson marginalizim tjetër dhe se çdo privilegj ose marginalizim ekziston në rrafsh të ndryshëm që ndërpret tjetrin. Përqendrimi i tillë ndihmon të shmanget që avancimi pozitiv të humbet në diskutim rreth çështjes kush është viktimë më e madhe e shtypjes. Njëkohësisht i ndihmon pjesëmarrësve të kuptojnë se ekzistojnë grupe të marginalizuara në kuadër të grupeve të marginalizuara. Shëtitja e privilegjeve ishte kritikuar për shkak se nga ajo më së shumti dobi kanë grupet dominuese (gjegjësisht ata me SES të lartë), sepse supozohet se ato mësojnë më së shumti dhe se ushtrimi shkakton që pjesëmarrësit më të marginalizuar të ndjehen të lënduar. Megjithatë, edhe pse ky ushtrim nuk është perfekt, shëtitja e privilegjit paraqet mënyrë e cila sjell më pak mundësi për konfrontim gjatë bisedës rreth çështjes së privilegjeve dhe nxitjes së refleksionit. U ndihmon njerëzve të hapen, në plot kuptimin e fjalës, nëpër hapa në vend të fjalëve të cilët vështirë artikulohehen dhe të lidhen njëri me tjetrin në një mënyrë tjetër.



### Activity:

1. Pjesëmarrësit duhet të renditen në vijë të drejtë në mes të një hapësire ashtu që të kenë hapësirë të mjaftueshme që gjatë ushtrimit të lëvizin para dhe prapa.
2. Pjesëmarrësit duhet të mbahen për dore ose të vënë njëri-njëri në supin e personit që qëndron afër tij – majtas ose djathtas në varësi nga hapësira e cila është në dispozicion. (Me rëndësi: Patjetër pyetni pjesëmarrësit a është në rregull të prekin dikë ose që dikush t'i prek ata. Nëse ndonjë nuk pajtohet, nuk është i detyruar, dhe nga kjo nuk duhet të bëhet problem).
3. Mund të jepni sqarim për aktivitetin, si ai duhet t'i njoftoj për privilegjet dhe çka saktësisht është privilegj, ose mund ta filloni aktivitetin pa sqarim të këtillë hyrës.
4. Lexoni pjesëmarrësve vijuesen: "Do t'ju lexoj disa deklaratat me zë. Ju lutem lëvizni nëse deklaratat ka të bëjë me ju. Nëse nuk ndjeheni mirë që të pranoni se deklaratat ka të bëjë me ju, mos lëvizni derisa e lexoj: Askush nuk do të dijë se ajo ka të bëjë me ju".
5. Filloni t'i lexoni deklaratat qartë dhe me zë, me pushim të vogël pas çdo deklarate. Pushimi mund të zgjas aq sa mendoni se është e përshtatshme.

6. Kur do të mbaroni me leximin e deklaratave, udhëzoni pjesëmarrësit që të shohin ku gjenden në hapësirë në raport me pjesëmarrësi tjerë.
7. Të gjithë le të mblidhen në rreth për informatat kthyesë përfundimtare dhe për diskutim.

### Deklarata për Shëtitjen e privilegjit

1. Nëse jeni djathtak/e, ecni një hap para.
2. Nëse \_\_\_\_\_ e keni gjuhë amtare, ecni një hap para.
3. Nëse njëri apo të dy prindërit tuaj kanë të mbaruar arsimin e lartë, ecni një hap para.
4. Nëse tani kryesisht ose paraprakisht keni qenë i varur nga transporti publik, ecni një hap prapa.
5. Nëse keni mësuar paraprakisht në shkollë me njerëz për të cilët mendoni se janë të njëjtë me ju, ecni një hap para.
6. Nëse vazhdimisht ndjeheni të pasigurt kur ecni në këmbë në mbrëmje, ecni një hap prapa.
7. Nëse në shtëpi keni të punësuar ndihmës si për shembull shërbëtor, kopshtar, etj., ecni një hap para.
8. Nëse e keni studiuar kulturën e paraardhësve tuaj në shkollën fillore, ecni një hap para.
9. Nëse ju kanë përqeshur ose keni qenë viktimë e dhunës nga moshatarët për diçka që nuk keni mundur të ndryshoni ose që ka qenë jashtë kontrollit tuaj, ecni një hap prapa.
10. Nëse familja juaj ndonjëherë e ka lëshuar atdheun tuaj ose kanë emigruar në vend tjetër pa dëshirë, ecni një hap prapa.
11. Nëse çdoherë do ta thërrisnit policinë kur do të ndodh problem pa u menduar fare apo pa u hamendur, ecni një hap para.
12. Nëse familja juaj posedon kompjuter, ecni një hap para.
13. Nëse ndonjëherë është dashur të kapërceni ndonjë ushqim ose keni qenë të uritur sepse nuk keni pasur të holla për të blerë ushqim, ecni një hap prapa.
14. Nëse mendoni se ju respektojnë për shkak të arritjeve tuaja akademike, ecni një hap para.
15. Nëse keni ndonjë pengesë të dukshme, ecni një hap prapa.
16. Nëse keni ndonjë sëmundje ose pengesë e cila nuk mund të vërehet, ecni një hap prapa.
17. Nëse ndonjëherë ju kanë penguar të merrni pjesë në ndonjë aktivitet për shkak të racës, klasës, përkatësisë etnike, gjinisë, pengesës ose orientimit seksual, ecni një hap prapa.
18. Nëse ndonjëherë keni qenë viktimë e profilizimit stereotip, ecni një hap prapa.
19. Nëse mendoni se identiteti juaj është i paraqitur mirë nga mediet, ecni një hap para.
20. Nëse ndonjëherë ju kanë pranuar për diçka që nuk e keni paraqitur sepse me ata keni raporte miqësore ose lidhje familjare, ecni një hap para.
21. Nëse familja juaj ka sigurim shëndetësor, ecni një hap para.
22. Nëse ndonjëherë dikush ju është drejtuar e ju nuk keni dashur t'ju drejtohen, ecni një hap prapa.
23. Nëse ndonjëherë në familjen tuaj keni pasur përdorues të drogës, ecni një hap prapa.
24. Nëse jeni anëtar i familjes me një prind, ecni një hap prapa.
25. Nëse jetoni në lagje me shkallë të lartë të kriminalitetit dhe keqpërdorimit të drogës, ecni një hap prapa.
26. Nëse ndonjëherë në familjen tuaj është ose ka qenë viktimë e sëmundjes mentale, ecni një hap prapa.
27. Nëse ndonjëherë jeni ndjerë keq për shkak të ndonjë barsolote të bërë në llogari të racës, përkatësisë fetare, përkatësisë etnike, gjinisë, pengesës suaj, por nuk keni dashur të konfrontoheni për shkak se jeni ndjerë i pasigurt, ecni një hap prapa.
28. Nëse ndonjëherë është kërkuar nga ju të flisni në emër të një grupi të njerëzve me të cilët e keni identitetin e njëjtë, ecni një hap para.
29. Nëse mundeni të bëni gabim e njerëzit mos ta atribuojnë sjelljen tuaj në mungesat që janë në lidhje me përkatësinë tuaj racore ose gjinore, ecni një hap para.
30. Nëse çdoherë keni supozuar se do të studioini, ecni një hap prapa.
31. Nëse keni më shumë se pesëdhjetë libra në shtëpi, ecni një hap para.
32. Nëse prindërit ju kanë thënë se mund të bëheni çdo gjë që dëshironi, ecni një hap para.

<sup>3</sup> E bazuar në aktivitetin e zhvilluar nga Rebeka Lejn (Rebeca Layne) dhe Rajan Çiu (Ryan Chiu) për orët e Pedagogjisë së zgjidhjes së konflikteve të dr. Artur Romanos (Arthur Romano) në Shkollën për analizë dhe zgjidhje të konflikteve në kuadër të Universitetit Xhorxh Mejson (George Mejsen) (2016).

## ▶ **Pyetje për informatat kthyese përfundimtare**

Gjatë kohës por edhe pas shëtitjes së privilegjit, pjesëmarrësit mund të ndjejnë ndjenja të ndryshme intensive pa marrë parasysh a qëndrojnë para apo prapa. Edhe pse qëllimi i shëtitjes së privilegjit është ta avancojnë kuptimin dhe pranimin e privilegjeve dhe marginalizimit, do të ishte koftra produktive që aktiviteti të përmbillet me emocione potenciale traumatike ose destruktive. Sesioni i informatave kthyese përfundimtare realizon qëllim të dyfishtë. Së pari, nëpërmjet pyetjeve që nxisin refleksion, u ndihmon pjesëmarrësve të kuptojnë si ndjehen sakt dhe të mbledhin guxim atë ta artikulojnë në nivel të pranueshëm për çdo pjesëmarrës. Ky proces do t'i eliminojë emocionet e mundshme negative dhe do të pengojë dëmet e mundshme. Së dyti, me eliminimin e emocioneve negative, informatat kthyese përfundimtare ju ndihmojnë pjesëmarrësve të kuptojnë se privilegjet ose marginalizimi janë pjesë integrale e qenies njerëzore. Në vend që t'i hedhim poshtë privilegjet ose marginalizimet, pjesëmarrësit mund të mësojnë si të pajtohen vet me veten dhe nëpërmjet përdorimit të vet njohjes së posa fituar, të realizojnë raport më të mirë me veten dhe me të tjerët rreth vete.

### ▶ **1. Si ndjeheshit kur ishit para në grup? Në pjesën e prapme të grupit? Në mes të grupit?**

Në fund të ushtrimit, nga pjesëmarrësit kërkohet të vërejnë ku ndodhen në hapësirë. Kjo është pyetje e zakonshme e cila përdoret si hyrje në diskutim dhe ju mundësojnë njerëzve të mendojnë çka ndodhte para se të fillojnë të punojnë me ide të tilla në mënyrë më abstrakte. E mban aktivitetin në fushën e përvojës dhe të së tashmes.

### ▶ **2. Në cilët faktor nuk keni menduar paraprakisht?**

Kjo kërkon nga pjesëmarrësit të mendojnë në kuptim më të gjerë për përvojat për të cilat nuk kanë menduar në mënyrën si u prezantuan në këtë aktivitet. Hap hapësirë për fillimin e bisedës rreth perceptimeve të tyre për aspektet e personalitetit të tyre dhe të njerëzve tjerë për të cilët përpara nuk kanë biseduar.

### ▶ **3. Nëse i keni ndërprerë kontaktet me personin afër jush, si u ndjetë atë çast?**

Kjo pyetje përqendrohet në përvojë konkrete të ndarjes që mund të ndodh gjatë këtij aktiviteti. Për disa pjesëmarrës, aspekti fizik siç është ky mund të jetë shumë intensiv. Ka shumë versione të shëtitjes së privilegjit që nuk përfshijnë kontakt fizik, por ky element plotësues mund të kontribuojë edhe me një përvojë dhe të jetë burim i përgjigjeve të pasura nga pjesëmarrësit.

### ▶ **4. Në cilën pyetje më së shumti u menduat? Nëse do të mundeshit, cilën pyetje do ta shtronit?**

Pjesa e parë e kësaj pyetje kërkon nga pjesëmarrësit të mendojnë për aktivitetin dhe atë çka shtrihet në bazën e saj. Pjesa e dytë e pyetjeve është shumë e rëndësishme për konstruktimin e njohurive. Pjesëmarrësit mund të propozojnë pyetje në cilat instruktorët as që kanë menduar. Parashtrimi i pyetjes si pjesëmarrësit do ta ndryshonin aktivitetin dhe pastaj duke i sendërtuar ato ndryshime janë pjesë e rëndësishme e të nxënies bashkëpunues.

### ▶ **5. Çka do të donin të dinë njerëzit për cilën do çështje të identitetit, gjendjes ose cenimit që ishin shkaktar të bëni hap prapa?**

Kjo pyetje i nxit njerëzit të cilët do të donin t'i shkëmbejnë përvojat e tyre si të marginalizuar. Kjo është mënyrë e mirë të nxitet diskutimi në këtë temë, Gjatë kësaj është me rëndësi që mos të prisni ose mos të detyroni ndonjërin nga pjesëmarrësit të merr fjalë, sepse kjo në mënyrë plotësuese do t'i marginalizonte dhe do të shkaktonte

të ndjehen të pasigurt. Nuk është obligim i të marginalizuarve t'i edukojnë të tjerët për marginalizimin e tyre. Nëse atë e duan, atëherë dëgjoni, nëse nuk e duan, atëherë respektoni vendimin e tyre.

### ▶ **6. Si kuptimi juaj për privilegjet ose marginalizimet tuaja do ta përmirësojnë raportin ekzistues me veten dhe me të tjerët?**

Kjo pyetje bazohet në idenë se njerëzit çdoherë mund t'i zbatojnë njohuritë dhe vetëdijen për veten që ta përmirësojnë jetën personale me veten dhe me ata përreth tyre që janë pjesë e asaj jete. I nxit pjesëmarrësit të mendojnë si ky kuptim mund të shkaktoj ndryshime pozitive. Nuk është i dedikuar vetëm për pjesëmarrësit më të privilegjuar, por edhe që pjesëmarrësit e marginalizuar të mundën t'i kuptojnë ata në grup që ndoshta përjetojnë marginalizim të ndryshëm. Kjo mund në diskutim ta lidh pyetjen e parë, kur vërente si qëndronin të ndarë, me pyetjen e fundit, e cila shqyrton si mund të punojnë që të qëndrojnë së bashku.



Vërejtje: \_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## 11. Aktiviteti: Pasioni për modën

### Materiale të nevojshme:

- Rroba të vjetra (pantallona, bluza, xhaketa)
- Gërshërë
- Gjilpërë dhe pe
- Ngjitëse
- ...

### Aktivite për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (8-14)

### Përgatitje:

Kërkoni nga nxënësit dh prindërit të sjellin rroba të vjetra. Sqaroni se në shkollë ka vend të caktuar të shënuar si Këndi i modës i dedikuar për dhurimin e rrobave të vjetra.

Përveç kësaj, ftoni që të bashkëngjiten në Seksionin e modës të cilin e formoni. Sqaroni se të gjithë pjesëmarrësit do të punojnë në rrobat e dhuruara që t'i rimodelojnë dhe t'i bëjnë më interesante dhe më moderne. Kujdesuni që edhe prindërit të cilët luftojnë me varfërinë t'i bashkohen këtij grupi, sepse ashtu edhe vet do të kontribuojnë dhe do të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë. Njëkohësisht, ky aktivitet do të kontribuojë që prindërit e klasës suaj të bashkëpunojnë dhe të njihen ndërmjet tyre. Ide shumë të mëdha paraqiten kur njoftohemi, njihemi dhe e respektojmë traditën tonë, përkatësinë fetare, zakonet, origjinin dhe kur me këtë ballafaqohemi përditë.

### Aktiviteti:

Organizoni mbledhje të zakonshme të Seksionit të modës çdo javë. Detyrë e seksionit është që të punojë në rrobat e vjetra dhe të shprehen në mënyrë kreative e gjatë kësaj duke u përpjekur të krijojë kreacione moderne dhe interesante. Sqaroni të gjithë pjesëmarrësve se produkti i gatshëm do të lihet në Këndin e modës nga ku nxënësit do të mund të huazojnë. Me këtë aktivitet i jepni dimension tjetër rrobave të dhuruara, tani më nuk bëhet fjalë për aksion vullnetar për të ndihmuar një grup, por për proces kreativ ku të gjithë fëmijët mund të gjejnë diçka interesante. Njëkohësisht krijoni rroba moderne e cila mund të përdoret nga nxënësit që ballafaqohen me varfërinë.

### Ide +:

- Kur dhënia dhe marrja do të vendosen si praktik e rregullt në shkollë, mund të filloni me aksionin e dhurimit të mjeteve shkollore, fustaneve të maturës, etj.

### Vërejtje:

## 12. Aktiviteti: Krenohemi me nxënësit tanë

### Materiale të nevojshme:

- Fleta të mëdha të letrës (flipçart)
- Marker dhe ngjyra
- Gërshërë
- Ngjitëse
- Fotografi

### Aktivite për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (8-14)

### Përgatitje:

Lajmëroni ose shkruani të gjithë prindërve të fëmijëve të klasës suaj porosi që të kërkoni nga ata fotografi të nxënësve tuaj. Sqaroni se jeni duke përgatitur poster për në klasë. Përveç kësaj, gjeni fotografi nga ndonjë nxënës që e keni pasur përpara (nxënës të cilët kanë arritur sukses në profesion ose që janë bërë sportist, muzikant, artist të njohur, etj.).

### Aktiviteti:

Këtë aktivitet mund ta realizoni si pjesë e punëtorisë për prindër dhe nxënës. Qëllimi është që të bëhet poster me fotografi të të gjithë nxënësve tuaj të mëhershëm por edhe të atyre që i keni tani. Ky poster duhet të qëndrojë në klasën tuaj. Me të pranishmit duhet të shkëmbeni tregimet jetësore motivuese të nxënësve tuaj të mëhershëm. Tregoni nga ku kanë filluar dhe me çka janë ballafaquar. Vëni në poster fotografi të futbollistëve të njohur (për shembull Agim Ibrahim) me çka do t'i nxisni nxënësit më të cenushtëm të zhvillojnë ëndrra ambicioze dhe të punojnë më herët që t'i realizojnë. Njëkohësisht kujdesuni që të përfshini fotografi të nxënësve të mëhershëm të cilët nuk kanë profesione aq të shquar dhe punojnë për shembull si postier, pastrues, infermiere, etj., që nxënësit të mund të kuptojnë se secili nga ne kontribuon në shoqëri në mënyrë të ndryshëm por njëlloj të rëndësishëm.

### Ide +:

- Nëse mbani kontakte me ndonjë nga nxënësit të mëhershëm të cilët kanë karrierë të suksesshme e që kanë luftuar me varfërinë, ftoni që të mbajnë fjalim motivues në ndonjërin nga ngjarjet e klasës.

### Vërejtje:

### 13. Aktiviteti: Të ecësh në këpucë të huaja

#### Materiale të nevojshme:

- Fletë letre
- Fletë të mëdha letre (flipçart) për secilin grup
- Marker
- Stilolapsa

#### Aktivitetet për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës

#### Përgatitje:

Përgatitni punëtorin për prindërit e nxënësve tuaj. Klasa duhet të jetë e rregulluar për punë në grupe.

Caktoni punëtorinë në kohë e cila është e përshtatshme për të gjithë prindërit (të punësuar dhe të papunësuar).

Përgatitni fletë pune me studime të rastit siç janë shembujt vijues:

**Edoni** ka 9 vjet. Ritet me një prind. Nëna e tij punon pas dite si pastruese në një zyrë të madhe. E ka të vështirë t'i paguajë llogaritë dhe të sigurojë ushqim. Është e lumtur që ka punë, por nuk është e lumtur që ajo duhet të jetë pasdite, prandaj kalon pak kohë me Edonin dhe nuk mund t'i ndihmojë në detyrat e shtëpisë.

**Jona** uka 14 vjet dhe është njëra nga katër fëmijët. Jeton me prindërit dhe gjyshin dhe gjyshen në një banesë me dy dhoma. Që kur babait të saj ia zbuluan kancerin, tërë pensioni i gjyshit dhe gjyshes shpenzohet në barna. Nëna e saj punon por nuk mund të fitojë sasi të mjaftueshme për t'i paguar llogaritë dhe ushqimin.

**Adea** uka 10 vjet. Shkon në shkollë publike ku i kanë dhënë një uniform shkollore (uniforma është e detyrueshme). Të gjithë fëmijët e klasës së saj kanë blerë së paku tre uniforma rezerve, por prindërit e saj nuk mund ta bëjnë këtë. Të dy janë të papunësuar. Babai i saj punonte si kamerier në një restorant, por për fat të keq restoranti para pak kohe u mbyll. Ai përpiqet të gjejë punë tjetër por nuk mund të gjejë asgjë.

**Merita dhe Arita** ukanë nga 10 vjet. Ato janë binjake dhe jetojnë me gjyshin dhe gjyshen. Prindërit e tyre gjatë kohë u përpoqën të gjejnë punë, por nuk mundën të gjejnë. Një kohë huazonin të holla që t'i mbulojnë shpenzimet mujore. Duke mos mundur të gjejnë punë në vend ato emigruan në Belgjikë dhe punojnë si pastruese në një qendër tregtare dhe si punëtor në ndërtim. Punojnë për rrogë minimale por arrijnë t'u dërgojnë pak të holla prindërve që t'i paguajnë borxhet e tyre si dhe dërgojnë pak të holla për Meritën dhe Aritën. Binjaket nuk janë të lumtura që jetojnë të ndarë nga prindërit.

**Bujari** uka 8 vjet. I ati ishte lënduar në fatkeqësi komunikacioni. Deri në atë çast jetonin jetë normale. Babi i tij punonte dhe kujdesej për familjen. Nëna e tij nuk punonte, sepse kishte vendosur të kujdesej për Bujarin dhe dy vëllezërit e tij. Pas fatkeqësisë, i ati nuk ishte në gjendje të punojë e nëna e tij nuk mundej lehtë të gjejë punë sepse ka qenë e papunësuar më shumë se 10 vite.

**Kushtoni vëmendje të veçantë që asnjë nga shembujt mos t'i ngjajë ndonjë situatë e cila paraqitet në klasën tuaj, sepse ajo mund të jetë e pakëndshme për disa prindër.**

#### Aktiviteti:

Ndani prindërit në tre grupe: secili grup do të merr fletë të punës me të njëjtat studime të rastit. Detyra e tyre është t'i lexojnë, t'i diskutojnë dhe t'i shënojnë shkaqet dhe pasojat e secilës gjendje në një fletë të madhe letre.

#### Për shembull:

	Shkaku	Pasoja
<b>Edoni</b>	Prindi punon për pagë minimale, mungesë e babait, llogari të larta	Lëshon aktivitete dhe kohë me prindin, mungesë e ushqimit, stresi, etj.
<b>Merita dhe Arita</b>	Prindër të papunësuar	Mungesë të veshmbathjes, mungesë e ushqimit, ndarje nga prindërit, etj.
<b>Bujari</b>	Nënë e papunësuar, babi pas fatkeqësisë së komunikacionit i paafte për punë	Turp, izolim social, mungesë e ushqimit, stres, etj.

Tregoni shkaqet e ndryshme për varfërinë me çka do t'i nxisni prindërit të mendojnë për marrjen e anës dhe paragjykimet e tyre. Varfëria mund të gjejë secilin dhe në çdo kohë!

Pasi që të përfundoni pjesën e parë të aktivitetit, thoni se në pjesën e dytë do të punohet në mënyrë individuale në shtëpi dhe se do të jetë anonime. Kërkoni nga prindërit të shkëmbejnë çka do të bënin nëse do të gjendeshin në atë situatë. Çfarë lloj të ndihmës do të pranonin? Çka do të bënit nëse e kuptoni se ndonjëri në klasën e fëmijës së tyre është në situatë të tillë? Çfarë ndihme do të ofronit?

Lusni t'i lënë fletët e letrës me mendimet e tyre në kutinë e shënuar që ndodhet afër derës ditën e nesërme kur do t'i sjellin apo kur do t'i marrin fëmijët.

Nga ky aktivitet do të dalin shumë ide për aktivitete të cilat mund t'i ndërmerrni që të ndihmoni ndonjë fëmijë ose familje që ka nevojë.

#### Vërejtje:

---



---



---

## 14. Aktiviteti: Dekorimi i klasës

<b>Materiale të nevojshme:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Ngjyra</li><li>• Vegla për ngjyrosje</li></ul>	<b>Aktivitete për:</b> <ul style="list-style-type: none"><li><input checked="" type="checkbox"/> Mësimdhënës</li><li><input checked="" type="checkbox"/> Prindër</li><li><input checked="" type="checkbox"/> Nxënës (8-14)</li></ul>
---	--

### Përgatitje:

Dita e shtunë është ditë përkryer për këtë aktivitet. Që të përgatiteni për këtë aktivitet, kërkoni nga prindërit të sjellin nga shtëpia sende të cilat nuk i përdorin (qebe, jastëk, rafta për libra, etj.).

### Aktiviteti:

Sqaroni prindërve se të gjithë do të punoni në dekorimin e klasës ku mësojnë fëmijët e tyre. ndani në grupe dhe secilit grup jepni detyrë të ndryshme: njëri grup do të punojë në këndin e gjuhës, tjetri në këndin e matematikës, një grup do të punojë në ngjyrosjen e derës, kurse të tjerët do të punojnë në perdet dhe dritaret. Është me rëndësi që të gjithë të përfshihen dhe pamja përfundimtare e klasës ta reflektojë kulturën e të gjithë fëmijëve dhe prindërve të tyre si dhe vizionit dhe interesat e tyre. Ndjenja e përkatësisë ndërtohet ashtu që do të sendërtohen elementet e ambientit shtëpiak të fëmijëve, duke përfshirë gjuhët të cilat i flasin në shtëpi, rutinën të cilën e ndjekin dhe sendet nga shtëpia të cilat janë të rëndësishme për fëmijët. Edhe fëmijët edhe prindërit do të ndjehen se përshtaten kur do të mundën të njihen në klasë.

Nëse mësimdhënësi do të kujdeset që çdo fëmijë të ndjehet i mirë se ardhur, atëherë të gjithë fëmijëve u dërgohet porosia se çdo individ respektohet, se çdo fëmijë dhe familje është pjesë e rëndësishme e bashkësisë shkollore dhe se çdo fëmijë mund të ketë dobi nga hapësira dhe resurset e përbashkëta dhe se mund të merr pjesë në mirëmbajtjen e tyre.

 Vërejtje: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_

## 15. Aktiviteti: Shkëmbejmë dhe kujdesemi


<b>Materiale të nevojshme:</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Çdo gjë që do të sjellin prindërit</li></ul>	<b>Aktivitete për:</b> <ul style="list-style-type: none"><li><input checked="" type="checkbox"/> Mësimdhënës</li><li><input checked="" type="checkbox"/> Prindër</li><li><input checked="" type="checkbox"/> Nxënës (8-14)</li></ul>
---	--

### Përgatitje:

Zgjidhni një ditë në muaj të jetë ditë e hapur me emrin "Dita kur shkëmbejmë dhe kujdesemi". Çdoherë zgjidhni prind të ndryshëm ta organizojë këtë ditë së bashku me ju. Të gjithë prindërit tjerë duhet të marrin pjesë.

### Aktiviteti:

Sqaroni prindërve se kjo nuk është ditë kur duhet të bëhen gjëra grandioze, por ditë kur i mësojmë fëmijët për rëndësinë të mendohet për dikë tjetër përveç për veten. Prindërit mund të shkëmbejnë ushqim, veshje, materiale shkollore ose tregim për atë si janë kujdesur për dikë ose si dikush është kujdesur për ata. Me rëndësi është të ketë dialog të hapur për temën dhënie dhe pranimit të dhuratës/donacionit. Roli juaj është kyç. Ju duhet i/e pari/a të shkëmbeni një tregim. Mos harroni: fëmijët në shkollën tuaj nuk do të jenë të vetmit që do të kenë dobi nga kjo mirësi e cila e stolis tërë personelin. Shpirti i kujdesit e tejkalon çdo nxënës veç e veç dhe e prek çdo anëtarë të bashkësisë. Me rëndësi është që të punohet me prindërit dhe nxënësit që ta kuptojnë rëndësinë e shkëmbimit dhe kujdesit. Punoni me prindërit dhe shkëmbeni këshilla si t'i mësojnë fëmijët e tyre të shkëmbejnë dhe të kujdesen. Çdoherë përdorni raste të ndryshme t'i mësoni si të kujdesen për kafshët, për natyrën, vëllezërit dhe motrat, etj. Do të befasoheni nga aktivitetet të cilat vet do t'i realizojnë.

 Vërejtje: \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_



## 16. Aktiviteti: Aftësi ripërtëritëse psikologjike

### Materiale të nevojshme:

- Fleta letre
- Ngjyra/stilolapsa
- Tabelë e bardhë
- Marker

### Aktivitete për:

- Mësimdhënës
- Prindër
- Nxënës (12-18)



### Qëllime:

- Zbuloni cilat kanale të aftësive ripërtëritëse i përdorim;
- Zbuloni cilat kanale nuk përdoren në sasi të mjaftueshme e cilat duhet t'i zhvillojmë që të ballafaqohemi në mënyrë më efektive me problemin dhe të zhvillojmë aftësi ripërtëritëse personale..



### Hyrje:

**Si përgjigje ndaj stresit, traumës, krizës, konfliktit, ndryshimeve të rëndësishme në jetë, njerëzit përdorin strategji dhe kanale të ndryshme që të ballafaqohen me gjendjen e vështirë dhe “të mbijetojnë”. Megjithatë ekzistojnë kanale të shumta të aftësive ripërtëritëse që nuk përdoren. Ushtrimi ka për qëllim t'u ndihmohet pjesëmarrësve të hulumtojnë kanale të ndryshme për ballafaqimin me gjendje të vështira.**



### Hapat:

1. Krijimi i tregimit në gjashtë fotografi
2. Vizatimi i strupit
3. Të shkruarit të tregimit të shkurtë të bazuar në fotografitë
4. Shqyrtimi i tregimeve në grupe të vogla
5. Aktrimi i tregimit



### Metoda:

1. Kjo teknikë i dedikohet nxënësve më të vjetër ose të rriturve. Jepni pjesëmarrësve instruksione të vizatojnë ose të shkruajnë tregim me ndihmën e 6 fotografive përshkrime/fjali të shkurta. Është me rëndësi të theksohet se nuk është me rëndësi sa mirë janë vizatuar fotografitë dhe se kjo nuk do të vlerësohet. Nuk është me rëndësi që të gjithë t'i kuptojnë vizatimet e të tjerëve sepse secili do ta interpretojë vizatimin për vete.
2. Pjesëmarrësit duhet ta ndajnë fletën e letrës në gjashtë pjesë, por mos ta presin ose këpusin. Në pjesën e parë, secili duhet të vizatoj personazhin kryesor, heroin e tregimit.

Mund të jetë personazh nga tregimi, përralla, fil i vizatuar, lojë e videos ose nga jeta reale. Mund të jetë njeri, kafshë, send ose simbol, varet nga vetë pjesëmarrësit. Në pjesën e dytë duhet të vizatohet detyra e personazhit kryesor ose ndonjë ngjarje nga tregimi i tij/i saj. Në çdo tregim, personazhi kryesor duhet të kryejë ndonjë detyrë ose të ndërmerë ndonjë aksion. Në pjesën e tretë pjesëmarrësit duhet të vizatojnë dikë që i ndihmon personazhit kryesor (nëse është e mundshme t'i ndihmohet). Vizatimi katërt duhet të paraqes pengesë ose dikë që e vështirëson kryerjen e detyrës ose që paraqet kërcënim. Në pjesën e pestë të gjithë duhet të vizatojnë si personazhi kryesor e tejkalon pengesën ose e fiton atë që e vështirëson kryerjen e detyrës. Pjesa përfundimtare duhet të tregojë si mbaron tregimi, çka ndodh me personazhin kryesor.

3. Kur të gjithë do të vizatojnë tregimin e tyre, kërkoni e njëjtën ta shkruajnë në një fletë letre.
4. Pasi që secili pjesëmarrës do ta shkruaj tregimin e tij, kërkoni dy vullnetar të cilët do ta paraqesin tregimin e tyre para të tjerëve, derisa ju (fasilitatorët) e kategorizoni tregimin sipas Modelit BASIK Ph (BASIC Ph) në tabelë.
5. Pasi që pjesëmarrësit e kuptojnë parimin e “vlerësimit” sipas Modelit BASIK Ph, ndani pjesëmarrësit në grupe të vogla në të cilat vet ndërmjet vete do t'i vlerësojnë tregimet sipas Modelit, kurse ju do t'ju ndihmoni gjatë kësaj.
6. Në fund të ushtrimit zgjidhet një tregim dhe aktrohet. Nëse ka ende kohë edhe tregimet tjera mund të aktrohen dhe me këtë mund të përsëritet kjo punëtori.

**Vërejtje të rëndësishme:** Është me rëndësi të kemi kujdes gjatë ndarjes së roleve. Pjesëmarrësi tregimi i të cilit aktrohet duhet të jetë në publik (jo të aktrojë). Ai/ajo duhet ta shikojë shfaqjen e tregimit të tij/të saj nëpër sytë e skenaristit ose regjisorit. Rolet janë: personazhi kryesor (heroi), ndihmësi(të) dhe pengesa. Rolet u jepen atyre pjesëmarrësve të cilët kanë më së paku kanale të aftësive ripërtëritëse që vërehen te heroi i përshkruar, ndihmësi ose pengesa. Pjesëmarrësit tjerë janë këtu që ta mbështesin personazhin kryesor dhe ndihmësit.

Sjellja e një fëmije/pjesëmarrës në procesin e ballafaqimit me stresin do të jetë e dukshme nga çdo vizatim. Për shembull, nëse për personazh kryesor zgjedh zanën e malit (ose një fytyrë tjetër të imagjinuar) kjo tregon se imagjinata/fantazia është mënyrë e ballafaqimit me stresin. Qëllimi i tregimit është i lidhur me vlerat dhe besimet tona. Ndihma mund të jetë e vërtetë ose e paramenduar ose ndoshta paraqet ndonjë bindje e brendshme. Pengesa mund të jetë shoqërore, e paramenduar ose shumë reale, që kërkon zgjedhje konkrete. Më e rëndësishme është të përkufizohet cilat kanale të aftësive ripërtëritëse përdoret e cilat lihen pas dore. Ky vetëdijësim do të na ndihmojë të punojmë për përdorim të aftësive ripërtëritëse më pak të zbatuara.

Nëpërmjet analizës sa kanale të veçanta për kundërshtim të stresit përdoren në tregimet, mund të shohim cilat janë më të zhvilluar sepse ato më së shpeshti përdoren.

Tregimet vlerësohen sipas modelit nëpërmjet përdorimit të frazave komplete ose fjalëve individuale (në rast kur fjalët individuale janë njësi e pavarur). Secila njësi shënohet me shenjë të veçantë por edhe me minus shenjë nëse fjala ka konotacion negativ.

▶ **Llojet e aftësive ripërtëritëse:**

<b>KONTROLL</b>	Kuptim dhe vlerësim të proceseve mentale, procese, reaksione dhe aftësi personale – vet zbulim.
<b>PAVARËSI</b>	Vendosja e vijës mes personit dhe problemit, zhvillimi i distancës fizike dhe emocionale e gjatë kësaj plotësimi i nevojave personale.
<b>RAPORTE</b>	Mbajtje e raporteve të mira me njerëzit që na ndihmojnë, gjatë kësaj duke vendosur baraspeshë ndërmjet vetëdijes për nevojat tona personale dhe nevojave të njerëzve tjerë.
<b>NISMË</b>	Marrja e përgjegjësisë për problemet tona, gjatë kësaj duke vendosur kontroll dhe prirje për ballafaqim me momentet e vështira (në vend të shmangies së tyre).
<b>KREATIVITET</b>	Krijimi i rendit, estetikës dhe qëllimit në kaosin e problemeve ekzistuese, konflikteve, komunikimit të dëmtuar dhe ndjenja të dhimbshme.
<b>HUMOR</b>	Kërkimi i “humorit” në atë çka na lëndon, gjatë kësaj duke i tejkalar ndjenjat negative, pa interesimin dhe paaftësinë me ndihmën e humorit.
<b>MORAL</b>	Zhvillimi i vetëdijes e cila përveç që i plotëson nevojat personale, tregon për nevojën për aksion me të cilën realizohet e mira e përgjithshme për tërë bashkësinë.

**BAZIK Ph** - Njohja e reaksioneve dhe mundësive t’ju ndihmohet fëmijëve të ekspozuar në gjendje serioze të stresit në jetë.

**Modeli i BAZIK PH** kanalit na ndihmon t’i identifikojmë reaksionet dhe njëkohësisht t’ju ndihmojë fëmijëve të cilët kanë qenë të ekspozuar në përvoja stresi dhe traume, formave të ndryshme të abuzimit dhe në kushte të pavolitshme jetësore. Akronimi i modelit i pasqyron aspektet themelore të zhvillimit të aftësive ripërtëritëse të fëmijëve.

<b>B</b>	<b>Besime</b> dhe vlera – cilat mendime, besime, qëndrime, paragjykime dhe interpretime të gabuara i kanë fëmijët? Për shembull: nëse ndonjë sillet keq – e meriton të dënohet. Goditja/rrahja është forma themelore e disiplinës. Dashuria është përvojë e dhimbshme. Mos u beso të rriturve. Hesht dhe duro. Të isha më i mirë, kjo nuk do të ndodhte.
<b>A</b>	<b>Afekte</b> dhe emocione – cilat emocione dominojnë te këto fëmijë, si i shprehin (në mënyrë verbale dhe jo verbale), a i pranojnë? A i kthejnë emocionet personale kundër vetes me anë të sjelljes auto-shkatërruese ose i shtypin që shkakton pengesa (mungesa) në kanal? Për shembull: frikë, hidhërim, faj, paaftësi, hamendje, turp ose pikëllim.
<b>S</b>	Dimensioni <b>social</b> – socializim, role, grupe dhe organizata për mbështetje. Çfarë burim të mbështetjes përdor fëmija: socializim me shokët e klasës, anëtarëve të familjes, seksioneve shkollore, përgatitjes për marrje të përgjegjësisë? Me rëndësi është të ndiqet me kujdes a paraqitet ndjenja e tjetërsimit, izolimit dhe armiqësisë që është e zakonshme në kushte të pengesës në kanal.
<b>I</b>	<b>Imagjinatë</b> , intuitë, humor. A përdor fëmija kreativitet, fantazi dhe lojë (në mënyrë të shëndosh)? Ka problem në këtë kanal (pengesë), nëse në sjelljen e fëmijëve mund të vërehen lojëra shqetësuese/imagjinare.
<b>K</b>	<b>Kognicion (Njohje)</b> dhe koncepti i realitetit. Çka fëmija di, si zgjidh probleme, si përmbahet dhe sillet, si përdor dialog interno, si i ka të organizuar mendimet, veprimet a janë të arsyeshme dhe logjike. Pengesa në këtë kanal është qëndrimi se të menduarit është jologjik kurse gjykimet janë joreale/të gabuara.
<b>Ph</b>	Aktivitet <b>fizik</b> – a është fëmija aktiv, a merret me sport, a përdor teknika të relaksimit, a e përdor trupin që të shprehet, a është i përfshirë në shumë aktivitete – lëviz habitet, është i nervozuar, e tepron me ngrënie, etj. Pengesa në këtë kanal do të thotë çrregullim psikosomatik dhe sjellje auto-shkatërruese.

> **Si mund t'ju ndihmojmë fëmijëve që në mënyrë pozitive të zhvillojnë kanale të tyre për ballafaqim me ato?**

<b>B</b>	Ri vlerësimi i besimeve të pranuar, zhvillimi i vet respektimit, fotografi pozitive për vete, lëshimi i rolit të viktimës, ndryshim i identitetit të perceptuar të “fëmijës së keq” ose “viktimës së zakonshme”, shpërndarja e përgjegjësisë me ndonjë tjetër (mësimdhënës, psikolog, psikoterapeut...).
<b>A</b>	Fitimi i mprehtësisë, identifikimi dhe shprehja e ndjenjave personale; pranimi se nuk ka emocione të mira dhe të këqija, por vetëm të këndshme dhe të pakëndshme; të mësuarit si të kontrollohen emocionet; respektimi i emocioneve të të tjerëve.
<b>S</b>	Të mësuarit e shkathtësive të komunikimit, dhënies dhe shkëmbimit me të tjerët, mbështetje, të nxënës, empati, vendosja e strukturave të mbështetjes në familje, miq, shokë të klasës, klube dhe grupe në të cilat merr pjesë fëmija dhe ndjehet i dashur, i kuptuar dhe i respektuar, ku mund të kultivohet ndjenja e përkatësisë; zhvillimi i grupeve për vet ndihmë.
<b>I</b>	Përdorimi i vizatimeve, shkarravitjeve, modeleve të argjilat, luajtja e roleve, përdorimi i kukullave, librave, filmave, tregimeve dhe çdo gjë tjetër ku ekzistojnë personazhe kryesore, ngjarje dhe veprime, mundësi për aktrimin e roleve të ndryshme, për zhvillimin e imagjinatës dhe përdorimi i humorit.
<b>K</b>	Zhvillimi i potencialit intelektual, interesa, talente dhe dhunti; nxitja e kuriozitetit, zgjerimi i kuantumit të njohurive, informata, përvoja, të nxënës pozitiv, vet respektim, shpresë.
<b>Ph</b>	Zhvillimi i orientimit të hapësirë, ekzekutimi i lëvizjeve të qëllimshme, lidhje të mendimeve, emocioneve dhe sjelljeve. Aktivitet fizik i cili ndihmon të ulët tensioni dhe shqetësimi, të strukturohet koha dhe të tejkalohet parregullsia/kaosi nëpërmjet teknikave për relaksim, sport, vallëzim, etj.

**Vërejtje:** \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_  
 \_\_\_\_\_

▶ **2.3 AKTIVITETE VULLNETARE NË SHKOLLË - ÇFARË JU BIE NDËRMEND**

Aktivitetet e ndryshme vullnetare ndonjëherë janë mjete më të thjeshta dhe më të logjikshme për zhvillimin e empatisë të nxënësit dhe nxitjen e dëshirës që të ndihmojnë dhe të ndihmojnë për zgjedhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen grupe të caktuara. Grumbullimi i mjeteve mund të zgjidhë një pjesë të problemeve që rrjedhin nga mungesa e financave. Një formë e ndihmesës nxënësve me status të ulët socio-ekonomik është edhe blerja e librave, grumbullimi i teshave, grumbullimi i parave për mjete të ndryshme ndihmëse, siç janë syzet apo karrocet, apo edhe për ekskursionet shkollore. Por, veprimet e tilla vullnetare a kanë ndikime negative për të cilat ne nuk jemi të vetëdijshëm? Aktivitetet e tilla a mund të zgjidhin probleme të tillë në afat të shkurtër, por të krijojnë probleme të tjerë në afat të gjatë? A ka mënyrë adekuate tjetër që zhvillon empatinë, që iu ndihmohet të tjerëve, që i kujtojmë të tjerët dhe botën që na rrethon?

> **Mbajeni në mend:**

1. Skamja ndikon në zhvillimin socio-emocional dhe konjitiv të fëmijëve, në suksesin akademik, në mekanizmat për ballafaqim, në poshtërimin... Aktivitetet vullnetare kryesisht nënkuptojnë grumbullimin e mjeteve me të cilat blihen produkte të ndryshme (libra, lodra, mjete didaktike...). Por, grumbullimi i mjeteve nuk ndikon në zvogëlimin e resurseve psikologjike të fëmijëve. Nxënësve të cilëve ju ndihmohet me aktivitete vullnetare veçohen nga të tjerët. Ashtu që, të gjithë e kuptojnë problemin e nxënësve me status të ulët socio-ekonomik i cili paraqet një formë stresi. Nxënësit e tillë edhe më tepër ekspozohen gjatë periudhës së grumbullimit të mjeteve. Nëse planifikohet aktivitet vullnetarë, nuk duhet që nxënësit me status të ulët socio-ekonomik të veçohen nga të tjerët. Mund të grumbullohet një buxhet i përgjithshëm për ekskursionet shkollore pa pagesë, të gjendet një vend në klasë ku të gjithë nxënësit do të mund të shkëmbejnë materiale shkollore etj.
2. Grumbullimi publik i mjeteve i vendos nxënësit me status të ulët socio-ekonomik në fokusin e mësimdhënësve dhe nxënësve të tjerë. McLoyd (1998) dëshmoi se mësimdhënësit kanë pritje më të pakta nga nxënësit me status të ulët socio-ekonomik, kanë qëndrim më pak pozitiv ndaj tyre, dhe iu ofrojnë më pak mundësi për rezultate pozitive nga të mësuarit. Në aktivitetet e tilla, fokusi është te nxënësi dhe te gjendja të cilën synojmë ta ndryshojmë.

Për konceptin më të gjerë të skamjes rrallë herë bisedohet me nxënësit e tjerë, si edhe për faktin se njerëzit kanë pozita të ndryshme fillestare, se nxënësi nuk është fajtor për gjendjen e tij momentale, se padrejtësia dhe pabarazia janë çështje sistemore. Aktivitet vullnetare për grumbullimin e mjeteve mund t'i zvogëlojnë përkohësisht problemet financiare të nxënësit, por njëkohësisht të rrisin paragjykimet ndaj atij nxënësi.

3. Sipas teorisë së vetëvendosjes (Deci & Ryan, 2000), pjesa më e madhe e problemeve emocionale të nxënësve rrjedhin nga nevojat psikologjike të papërbushura, si: autonomia, kompetencat dhe ndërlidhja sociale. Nëse këtë

tre nevoja përmbushen, pa dallimin statusit socio-ekonomik të nxënësve, ata do të jenë të lumtur, do të ndjehen të pranuar nga shoqëria dhe do të besojnë se mund të japin kontribut në shoqëri. Kur planifikoni aktivitetet vullnetare, mendohuni nëse ai aktivitet do t'iu ndihmojë apo do t'iu bëjë dëm nxënësve në ndjesinë e të pasurit zgjedhje ose nëse mund të kenë ndikim në jetën e tyre apo në jetën e të tjerëve. Gjithashtu, duhet të keni kujdes që nxënësit të ndjejnë se kanë mundësi për zgjedhje, se kanë autonomi, se janë në lidhje me nxënësit e tjerë dhe mësimdhënësit dhe të ndjehen se janë të respektueshëm dhe të vlefshëm.

**4.** E njëjta vlen edhe për aktivitete vullnetare për nxënës dhe të rritur jashtë shkollës, në institucione të ndryshme, me aftësi të kufizuara të ndryshme, në vende të largëta dhe të varfra... Nëse vendosni që të grumbulloni resurse (veçanërisht për nxënës në vende të largëta), bisedoni me nxënësit tuaj për kontekstin më të gjerë, për barazinë e qenieve njerëzore, për pozitat e ndryshme fillestare, pabarazinë sistematike në nivel të klasës / shkollës, në nivel të politikave arsimore dhe në nivel të shoqërisë si tërësi.

**5.** Pas grumbullimit të resurseve për organizatat, njerëzit apo individët në gjendje të vështirë, përpuni që nxënësit të mund t'i takojnë njerëzit të cilëve kanë vendosur t'iu ndihmojnë. Mund që të kalojnë një ditë së bashku duke iu ofruar ndihmë vullnetare, duke mësuar njëri me tjetrin, duke zbuluar se edhe përkaj dallimeve ekzistojnë ngjashmëri të shumta midis nesh. Duhet pasur parasysh se nxënësit me status të ulët socio-ekonomik nuk mund të kontribuojnë në grumbullimin e ndihmave financiare, voluntarizmi është një mënyrë e mirë që ata të mund të kontribuojnë, t'iu ndihmojnë të tjerëve, të ndjehen të përmbushur dhe të kënaqur. Njëherë, mbajeni në mend, se shfrytëzuesit e shumë organizatave, institucioneve apo individëve do t'ju jenë shumë falënderues për kohën Tuaj dhe bashkëveprimin me Ju, sesa për vetë ndihmën financiare.

## Literatura dhe referencat:

1. 40 Kindness Activities & Empathy Worksheets for Students and Adults <https://positivepsychologyprogram.com/kindness-activities-empathy-worksheets/> (07/03/2019).
2. Battistich, V., Solomon, D., Kim, D. I., Watson, M. & Schaps, E. (1995). Schools as communities, poverty levels of student populations, and students' attitudes, motives, and performance: A multilevel analysis. *American educational research journal*, Vol. 32, No. 3, 627-658.
3. Bradley, R.H., Corwyn, R. F., Mcadoo, H. P. & Garcia Coll, C. (2001). The home environments of children in the United States part I: variations by age, ethnicity, and poverty status. *Child Development*, Vol. 72, 1844–1886.
4. Brkić, M. & Kožić, V. (Ed.) (2017). Start the Change workshop collection. Zagreb: Forum for Freedom in Education.
5. Brooks-Gunn, J. & Duncan, G. J. (1997). The effects of poverty on children. *Future Child*, Vol. 7, 55–71.
6. Brophy, J. E. & Good, T. L. (1986). Teacher behavior and student achievement. In M. C. Wittrock (Ed.), *Handbook of research on teaching* (3rd ed., 328-375). New York: Macmillan.
7. Burke Walsh, K. (1996). *Creating Child Centered Classrooms for 6-7 year olds*. Washington D.C.: Children's Resources International.
8. Burke Walsh, K. (1998). *Creating Child Centered Classrooms for 8-10 year olds*. Washington D.C.: Children's Resources International.
9. Burke Walsh, K., Kirandziska, S. & Lazarevski Gjorgieva T. (2009). *Создавање средина за учење на 21-от век (Creating a 21st century learning environment)*. Skopje: Foundation for Educational and Cultural Initiatives "Step by Step" - North Macedonia.
10. Burnett, N. (2008). Education for All: An Imperative for Reducing Poverty. *Annals of the New York Academy of Sciences*, Vol. 1136, 26 – 275.
11. Campbell, F. A., Ramey, C. T., Pungello, E., Sparling, J. & Miller-Johnson, S. (2002). Early Childhood Education: Young Adult Outcomes from the Abecedarian Project. *Applied Developmental Science*, Vol. 6, No. 1, 42–57.
12. Csikszentmihalyi, M. (1996). *Creativity: Flow and the Psychology of Discovery and Invention*. New York: HarperCollinsPublishers.
13. Dearing, E. (2008). Psychological Costs of Growing Up Poor. *Annals of the New York Academy of Sciences*, Vol. 1136, 324–332.
14. Duncan, G.J. & Brooks-Gunn, J. (1997). Income effects across the Life Span: Integration and Interpretation. In G.J. Duncan & J. Brooks-Gunn (Eds.), *Consequences of Growing Up Poor* (596–610). New York: Russell Sage Foundation.

15. Duncan, G.J., Yeung, J.W., Brooks-Gunn, J. & Smith, J.R. (1998). How much does poverty affect the life chances of children? *American Sociological Review*, Vol. 63, 406–423.
16. Eccles, J. S. & Barber, B. L. (1999). Student council, volunteering, basketball, or marching band: What kind of extracurricular involvement matters? *Journal of Adolescent Research*, Vol. 14, 10–43.
17. Elder, G.H. & Caspi, A. (1988). Economic stress in lives: developmental perspectives. *Journal of Social Issues*, Vol. 44, 25–45.
18. Engle, P. L. & Black, M. M. (2008). The Effect of Poverty on Child Development and Educational Outcomes. *Annals of the New York Academy of Sciences*, Vol. 1136, 243–256.
19. Feldman, A. & Matjasko, J. L. (2005). The Role of School-Based Extracurricular Activities in Adolescent Development: A Comprehensive Review and Future Directions. *Review of Educational Research*, Vol. 75, No. 2, 196.
20. Foster, E.M. (2002). How economists think about family resources and child development. *Child Development*, Vol. 73, 1904–1914.
21. Fredricks, J. A. & Eccles, J. S. (2006). Is extracurricular participation associated with beneficial outcomes? Concurrent and longitudinal relations. *Developmental psychology*, Vol. 42, No. 4, 698.
22. Fullan, M. (1991). *The New Meaning of Educational Change*. New York, NY: Teachers' College Press.
23. Gomby, D., Culross, P. & Behrman, R. (1998). Home Visiting: Recent Program Evaluations. *The Future of Children*, Vol. 9, 4–26.
24. Gorski, P. (2008). The Myth of the Culture of Poverty. *Educational Leadership*, Vol. 65, No. 7, 32–36.
25. Gorski, P. (2013). Reaching and teaching students in poverty: Strategies for erasing the opportunity gap. New York, NY: Teachers College Press.
26. Kožić Komar, V. & Pavlović, V. (2018). *Book of Good Ideas – school projects promoting diversity, social justice and critical thinking*. Zagreb: Forum for Freedom in Education.
27. Love, J.M et al. (2005). The effectiveness of early head start for 3-year-old children and their parents: lessons for policy and programs. *Developmental Psychology*, Vol. 41, 885–901.
28. Mahoney, J. L. & Cairns, R. B. (1997). Do extracurricular activities protect against early school dropout? *Developmental Psychology*, Vol. 33, 241–253.
29. Mahoney, J. L. & Stattin, H. (2000). Leisure activities and adolescent antisocial behavior: The role of structure and social context. *Journal of Adolescence*, Vol. 23, No. 2, 113–127.
30. Marsh, H. W. & Kleitman, S. (2002). Extracurricular school activities: The good, the bad, and the non-linear. *Harvard Educational Review*, Vol. 72, 464–514.
31. McLoyd, V.C. (1998). Socioeconomic Disadvantage and Child Development. *American Psychologist*, Vol. 53, No. 2, 18 –204.
32. Mlekuž, A., Veldin, M. & Haugas, S. (2018). Analytical report Education and Socio-Economic Status – Estonian case. Zagreb: Network of Education Policy Centres.
33. Narayan, D. & Petesch, P. (2007). Agency, opportunity structure and poverty escapes. In D. Narayan & P. Petesch (Eds.), *Moving out of Poverty: Cross-Disciplinary Perspectives on Mobility*, Washington DC: Palgrave MacMillian and The World Bank.
34. Pavlović, V. (2018). Student's perspectives of participation in extra-curricular activities in vocational schools. Unpublished Master's Thesis, Linköping: Linköping University - Department of Child Studies.
35. Pavlović, V., Munivrana, A., Roth, M. & Perak, J. (2017). Start the Change! - Young people in the world of diversity: handbook for schools (59 – 60, 108, 120). Zagreb: Forum for Freedom in Education.
36. Pianta, R., La Paro, K.M., Payne, C. (2002). The relation of kindergarten classroom environment to teacher, family, and school characteristics and child outcomes. *Elementary School Journal*, Vol. 102, 225–238.
37. Reynolds, A.J., Temple, J. A., Ou, S. R., Robertson, D. L., Mersky, J. P., Topitzes, J. W. & Niles, M. D. (2007). Effects of a school-based, early childhood intervention on adult health and well-being: a 19-year follow-up of low-income families. *Arch. Pediatr. Adolesc. Med.* Vol. 161, 730–739.
38. Rosental, R., & Jacobson, L. (1968). Pygmalion in the classroom: Teacher expectations and pupils' intellectual development. New York: Holt, Rinehart and Winston.
39. Raleva, M. & Boshkovska, M. (2004). Да го отвориме кругот - Прирачник за работа со деца и млади (Let's open the circle - Handbook for children and youth). Skopje: Foundation for Educational and Cultural Initiatives "Step by Step" - North Macedonia.
40. Roth, M., Pavlović, V., Morić, D. (2015). *Volonterska kuharica – priručnik za pokretanje volonterskih programa u školama*. Zagreb: Forum for Freedom in Education.
41. Ryan, W. (1976). *Blaming the victim*. New York: Random House, Inc.
42. School Education Gateway (2015). Involving parents and local community to reduce school drop-outs. Available at: [https://www.schooleducationgateway.eu/en/pub/practices/involving\\_parents\\_and\\_local\\_co.htm](https://www.schooleducationgateway.eu/en/pub/practices/involving_parents_and_local_co.htm) (07/03/2019).
43. Schweinhart, L.J., Montie, J., Xiang, Barnett, W.S., Belfield, C. R. & Nores, M. (2005). *Lifetime Effects: The High/Scope Perry Preschool Study through Age 40*. Monographs of the High/Scope Educational Research Foundation (No. 14). Ypsilanti, MI: High Scope Press.
44. Seligman, M. (2011). *Flourish: A new understanding of happiness and well-being – and how to achieve them*. London: Nicholas Brealey.
45. Sharp, R. (2014). *Ready, steady, action: what enables young people to perceive*

themselves as active agents in their lives?, *Educational Psychology in Practice: theory, research and practice in educational psychology*, Vol. 30, No. 4, 347-364, Available at: [10.1080/02667363.2014.939143](https://doi.org/10.1080/02667363.2014.939143)

46. Solomon, D. & Kendall, A. J. (1979). *Children in classrooms: An investigation of person-environment interaction*. New York: Praeger.
47. Stern, N. (2003). *Foreword to Pathways Out of Poverty: Private Firms and Economic Mobility in Developing Countries*. Boston: Kluwer.
48. Sweet, M. & Appelbaum, M. (2004). Is home visiting an effective strategy? A meta-analytic review of home visiting programs for families with young children. *Child Development*, Vol. 75, 1435–1456.
49. Taylor, B.A., Dearing, E. & McCartney, K. (2004). Incomes and outcomes in early childhood, *Journal of Human Resources*, Vol. 39, 980–1007.
50. Thoits, P. A. & Hewitt, L. N. (2001). Volunteer Work and Well-Being. *Journal of Health and Social Behaviour*, Vol. 42, No. 2, 115-131. Available at: <https://doi.org/10.2307/3090173>
51. Vranješević, J. (2012). Intercultural education: development of teachers' professional competencies. In Š. Alibabić, S. Medić & B. Bodroški–Spariosu (Eds.), *Quality in Education – challenges and perspectives*, (301–312). Belgrade: Faculty of Philosophy, Department for Pedagogy and Andragogy.
52. Vuković Vidačić, J. (2016). Školska kultura, (36 – 37, 40) [online] Repozitorij Filozofskog fakulteta u Rijeci. Available at: <https://urn.nsk.hr/urn:nbn:hr:186:738178>
53. Welzel, C. & Inglehart, R. (2010). Agency, values, and well-being: A human development model. *Social Indicators Research*, Vol. 97, 43–63.
54. Youniss, J., Yates, M. & Su, Y. (1997). Social integration: Community service and marijuana use in high school seniors. *Journal of Adolescent Research*, Vol. 12, 245–262.
55. Zaff, J., Moore, K. A, Papillo, R. & Williams, S. (2003). Implications of Extracurricular Activity Participation During Adolescence on Positive Outcomes. *Journal of Adolescent Research*, Vol. 18, No. 6, 600.
56. Zakia, R. D. (1995). *Quotes for Teachers*. [online] Rochester Institute of Technology. Available at: <https://people.rit.edu/andpph/text-quotations.html>

